



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional
“Menaxhim i Ndërmarrjeve”, me profil: “Menaxhim i
Ndërmarrjeve të Agrobiznesit”**

i

**Institucionit të Arsimit të Lartë
“Universiteti Bujqësor i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Albana Madhi
2. Dr. Alban Korbi

Shtator/2019

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës 200 - 400 fjalë

Universiteti Bujqësor i Tiranës (përmendur në vijim me inicialet UBT) është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 548, datë 28.07.1951 dhe është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 11, datë 07.04.2017, me kohëzgjatjen 4 vite, me afat vlefshmërie deri më 06.04.2021. Aktet rregullative të IAL-së, Statuti dhe Rregulloret e Institucionit, janë rishikuar në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe aktet normative në fuqi, siç është konstatuar edhe nga GVJ. Institucioni ka përgatitur një Plan Strategjik i cili është i nevojshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të programit të studimit si edhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve që diplomohen.

UBT përbëhet nga 5 Fakultete dhe 1 Institut i Resurseve Gjenetike të Bimëve.

Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim i Ndërmarrjeve” me profil: “Menaxhim i Ndërmarrjeve të Agrobiznesit”, ofrohet nga Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit (DDA), të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA), në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT).

Ky fakultet përbëhet nga:

- Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit;
- Departamenti i Ekonomisë dhe i Politikave të Zhvillimit Rural;
- Departamenti i Financë-Kontabilitetit;
- Departamenti i Matematikës dhe Informatikës;
- Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural;
- Departamenti i Gjuhëve të Huaja;
- Instituti i Ekonomisë dhe i Vlerësimit të Njohurive.

Programi i studimit është hapur me VKM Nr. 880, datë 12.08.2009, nga FEA në DDA. Programi i studimit MP në “Menaxhim i ndërmarrjeve”, me profil: “Menaxhim i ndërmarrjeve të agrobiznesit” ofrohet me kohë të plotë dhe në gjuhën shqipe dhe kohëzgjatja e tij është 2 vite (4 semestra), me 120 ECTS në total.

Ky program studimi dhe përgatitja e dokumentave strategjike janë përpiluar edhe në konsideratë të zhvillimit socialo-ekonomik të vendit tonë si dhe një studimi analitik të tregut të punës. Siç shfaqet në dokumentat orientuese të përgatitura nga IAL nën vlerësim, programi i studimit synon t’u ofrojë studentëve njohuri të thelluara në menaxhimin e ndërmarrjeve, sidomos të atyre të agrobiznesit, si dhe pajisjen me instrumentat themelore të nevojshëm për të përditësuar aftësitë e tyre.

Programi respekton parashikimet e VKM Nr. 41, datë 24/01/2018. Stafi akademik i departamentit DDA, e cila është njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi, ka 20 anëtarë staf akademik dhe 1 anëtar staf ndihmës. Rekrutimi i personelit akademik bëhet

nëpërmjet procedurave të konkurimit dhe kriteret bazë të përcaktuara nga njësia përgjegjëse. Këto kriteret më pas miratohen nga autoriteti më i lartë drejtues i Institucionit (Rektori).

GVJ kërkoi dhe aksesoi gjatë vizitës të dhënat e nevojshme në lidhje me përbërjen e stafit dhe titujt akademik dhe gradat shkencore, të cilat u vunë në dispozicion. Ngarkesa e personelit akademik të UBT-së përfshin ngarkesën në veprimtarinë mësimdhënëse, në veprimtarinë shkencore, si dhe në angazhime të tjera administrative. Pjesë e ngarkesës janë dhe veprimtaritë në kualifikimin e vazhdueshëm profesional.

GVJ vlerëson se personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohet për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve dhe të politikave të zhvillimit të institucionit. Institucioni zotëron të dhëna të sakta sa i përket punimeve shkencore të personelit akademik, të cilat rezultojnë në dosjet personale të tyre.

Institucioni realizon vlerësim nga ana e studentit të programit nëpërmjet aplikimit të pyetësorit. Vlerësimi realizohet gjithashtu nga drejtuesi i njësisë bazë por edhe në nivel Fakulteti e Rektorati nëpërmjet shkëmbimit interaktiv me stafin dhe vlerësimeve në fund të vitit.

UBT ofron infrastrukturë të qëndrueshme për veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe administrative në funksion të programit të studimit Master Profesional në “Menaxhim i ndërmarrjeve”, me profil: “Menaxhim i ndërmarrjeve të agrobiznesit”, duke mundësuar arritjen e objektivave. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e universitetit e cila ofron database elektronike por dhe një shumëllojshmëri titujsh leximi në sallën e leximit. **Tërhiqet vëmendja që të rinovohen kontratat për akses në revistat shkencore online, të cilat për momentin nuk ishin të aksesueshme.**

Mjediset në të cilat zhvillohet aktiviteti akademik kanë standardin e nevojshëm për realizimin e qëllimeve specifike që duhet të arrihen nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Ambjentet e institucionit janë të përshtatshme për aktivitetin e mësimdhënies dhe aktivitetet ndihmëse. Laboratorët kompjuterikë kanë kapacitet me rreth 20- 25 vende.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave mat ecurinë e programeve të studimit për qëllime përmirësimi duke përdorur një metodologji me instrumente matëse dhe vlerësuese të tilla si: pyetësorë për studentët, raporte të njësive kryesore e njësive bazë, vlerësime për pedagogët të nivelit të njësisë por edhe Fakultetit apo rektoratit, vlerësues për praktikën, etj.

GVJ rekomandon një transparencë më të madhe në lidhje me të gjitha proceset e brendshme të zhvillimit të institucionit, sidomos në kuadrin e publikimeve on-line të raporteve, për t’jua bërë të ditur dhe studentëve dhe palëve të interesuara.

Pranimi i studentëve që ndjekin kete program studimi pranë UBT është realizuar sipas kriterëve që vendos ligji Nr. 80/2015, datë 21/05/2007 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë Statuti i UBT dhe Rregullorja e programit.

Në regjistrin e miratuar nga MASR, të administruar nga sekretaria mësimore e institucionit, janë pasqyruar në mënyrë të rregullt të dhënat lidhur me studentët e regjistruar në këtë program studimi. Të dhënat në regjistër janë në përputhje me dokumentacionin që gjendet në dosjen e studentit, gjë e cila rezultoi pas kontrollit të tyre, sipas një përzgjedhjeje të rastësishme.

Studentëve u jepet informacioni dhe këshillimi i duhur për karrierën nga Zyra përkatëse e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës dhe nga struktura të tjera të ngritura brenda UBT.

Institucioni mban të dhëna dhe kontakte me studentët e ketij programi studimi edhe pas diplomimit të tyre dhe favorizon punësimin e studentëve që kanë ndjekur studimet në të e i kanë përfunduar ato me rezultate të larta.

Institucioni i siguron personelit akademik informacionin e nevojshëm për programe të ndryshme studimi, me qëllim kualifikimi, brenda dhe jashtë vendit, duke realizuar zhvillimin e një sërë aktiviteteve me natyrë shkencore të tilla si, konferenca, seminare, leksione të hapura me figurat më në zë të fushës, ku është nxitur pjesëmarrja e personelit akademik.

Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ngjashme publike dhe jopublike.

Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe, vendase dhe të huaja, si dhe ka vendosur marrëdhënie të frutshme bashkëpunimi me subjekte të njohura të biznesit, në Shqipëri, për të mundësuar thellimin e njohurive dhe krijimin e mundësive të punësimit për studentët që frekuentojnë programin.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; 200 fjalë

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Master Profesional në “Menaxhim i Ndërmarrjeve”, me profil: “Menaxhim i Ndërmarrjeve të Agrobiznesit”, ka filluar pas ngritjes së Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) nga ana e ASCAL. Faza e parë ishte trajnimi i GVJ organizuar nga ASCAL, ku ekspertët u njohën me standardet e reja dhe template-t e RVJ dhe faza e dytë ishte shqyrtimi i Dosjes së Vetëvlerësimit të përcjellë nga UBT dhe vizita në Institucion.

I gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga UBT u vu në dispozicion nga ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Brendshëm të ASCAL (AMS). Pas shqytimit të tij, u hartua Agjenda e vizitës së GVJ në UBT, vizitë e cila u realizua në datë 21-22.05.2019. Sipas Agjendës së përcaktuar, GVJ pati takime me: Dekanin e FEA dhe Përgjegjës të Departamentit; Grupin e Vetëvlerësimit të programit; Stafin akademik të programit të studimit; Zyrën e Burimeve Njerëzore; Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Mësimit dhe Kurrikulave; Qendrën e Karrierës dhe ALUMNI; Zyrën e Studimeve dhe Studentëve; Studentët e programit të studimit. Takimet u mbyllën me një vizitë në Sekretarinë mësimore, bibliotekën, auditoret, laboratorët dhe shërbimet për studentët. Të gjitha informacionet e mbledhura nga këto takime si dhe dokumentat e dorëzuara nga UBT, u përdorën nga GVJ për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm.

Koordinatorë Teknike e ASCAL është Zj. Ersi Dako.

Më datë 31.07.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 44/56 Prot., datë 01.08.2019, dërgohet në Institucion Draft-Raportit i Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 18.09.2019, përmes sistemit AMS, Institucioni përcjell përgjigjen mbi Draft-Raportin, përmes së cilës shpreh dakordësinë me përmbajtjen e tij. Sa më lart, Draft-Raportit merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional
“Menaxhim i ndërmarrjeve”, me profil “Menaxhim i ndërmarrjeve të
agrobiznesit”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit MP në “Menaxhim i ndërmarrjeve”, me profil “Menaxhim i ndërmarrjeve të agrobiznesit”, i ofruar nga Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, UBT, është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit, të cilat janë të shprehura në planin strategjik të Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe planin strategjik të zhvillimit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Ky program është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës bazuar në një studim të tregut të punës të përgatitur nga institucioni që përfshin: mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas, rajonal, kombëtar apo ndërkombëtar.
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Ky program studimi është hartuar në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në Shqipëri. Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim i Ndërmarrjeve”, me profil “Menaxhim i Ndërmarrjeve të Agrobiznesit”, ruan dhe konsolidon vlerat akademike e kulturore kombëtare. (Statuti i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Neni 2, pika 1 dhe Neni 59, pika 1)
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	GVJ konstaton që ky program studimi është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e IAL dhe është bazuar dhe në një studim të detajuar tregu, për të qenë konkurrues në një treg kombëtar dhe ndërkombëtar. (Statuti / Plani strategjik)
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Nga konsultimi me dokumentat bazë dhe vizita në institucion GVJ konstaton se programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik lokal e kombëtar, që reflektohet kryesisht në kurrikulën e programit të studimit. Pas përfundimit të këtij programi studentët kanë përfutur aftësi se si të menaxhojnë një ndërmarrje agrobiznesi, duke u pajisur me shprehje të veçanta në fushën e menaxhimit të

	agrobiznesit, marketingut të produkteve bujqësore si edhe në atë të menaxhimit të burimeve njerëzore në këto ndërmarrje.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2				
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	GVJ vlerëson se ky program studimi është në përputhje e në zbatim me planin strategjik të IAL. (Plani strategjik i UBT-së, 2016-2025). Ky program studimi është mbështetur në Strategjinë kombëtare të bujqësisë.			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Duke analizuar dokumentat strategjike të UBT-së, (Statuti, Plani Strategjik, Rregullorja e Fakultetit dhe Departamentit) dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se ky program studimi është hartuar duke u mbështetur në këto dokumenta. Pra, ky program ndjek dhe zbaton misionin, qëllimin, metodat, dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit.			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Ky program studimi është në zbatim të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018. Programi ofrohet nga FEA dhe është në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.			
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	GVJ konstaton nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga UBT se ky program studimi është bazuar në mbështetje të planit të zhvillimit strategjik të UBT për periudhën 2016-2025 në të cilën janë parashikuar politikat e zhvillimit të programeve të studimeve master. Ky plan strategjik është në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit. Programi synon gjithashtu që t’u lehtësojë studentëve aplikimin për studime të mëtejshme në institucione rajonale e më gjerë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3				
Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Programet e studimit	Nga shqyrtimi i dokumentave rezulton se programi i studimit MP			

<p>“Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>në “Menaxhimi i Ndërmarrjeve të Agrobiznesit”, ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë ata në përfundim të këtij programi dhe këto janë në përputhje me atë që kërkon tregu.</p> <p>Ky program studimi (duke iu referuar dhe rregullores se tij dhe të DDA) ka qëllim parësor (duke reflektuar atë së çfarë kërkon tregu i punës në këtë sektor) përgatitjen e specialistëve me njohuri të thelluara, profesionale, të aftë, të mirë-orientuar në fushat e agrobiznesit, të njohin aspektet menaxheriale dhe kuadrin rregullator të sektorit të Agrobiznesit.</p> <p>Rezulton se nga ana e UBT është realizuar analiza e nevojave të tregut për hapjen/zhvillimin e këtij programi. Në këtë analizë janë marrë në shqyrtim karakteristikat e nevojave të tregut.</p> <p>Analiza e tregut të punës merr në shqyrtim mundësitë për punësim dhe nevojat e tregut në sektorin e agrobiznesit, në harmoni me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar. Sikundër u evidentua më lart, UBT ka bërë përpjekje për të analizuar nevojat e tregut të punës, në përshtatje me programin e studimit Master Profesional në “Menaxhim i Ndërmarrjeve”, me profil: “Menaxhim i Ndërmarrjeve të Agrobiznesit”. Përshtatja me këto nevoja reflektohet dhe në strategjinë e zhvillimit të programit. U konstatua, gjithashtu, nga takimet në institucion me studentët se pjesa më e madhe e tyre janë të punësuar. Gjithashtu, konstatohet që Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA) ka filluar të realizojë (është akoma në hapat e para) një studim me synim gjurmimin e ecurisë së studentëve të UBT, por edhe të studentëve të këtij program studimi, në tregun e punës, dhe pritshmeritë dhe kërkesat e tregut për të diplomuarit në këtë program.</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe vizita në Institucion, duke u përqendruar në takimin me studentët, stafin dhe me Qendrën e Karrierës dhe Alumni (QKA), rezulton se ky program studimi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës për specialistë të fushës së menaxhimit të fermave të vogla dhe të mesme blegtorale e bujqësore, të ndërmarrjeve të agrobiznesit, të sektorit bankar etj., dhe pajis studentët me aftësitë që kërkon tregu në të gjithë elementët e Menaxhimit të ndërmarrjeve të agrobiznesit.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të</p>	<p>Ky program studimi, duke u mbështetur në aktet e brendshme strategjike, është përpjekur të ndjekë përvojat e universiteteve europiane, gjë që është reflektuar në përmbajtjen e programit dhe në syllabus-et e lëndëve të veçanta. Kjo rezulton dhe nga</p>

ardhmen në tregun ndërkombëtar. Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.	mobilitetet e studentëve të këtij programi studimi në programe të ngjashme në Universitete të huaja. Programi synon gjithashtu që t'u lehtësojë studentëve aplikimin për studime të mëtejshme në institucione rajonale e më gjerë. GVJ konstaton se ky program studimi është hartuar në përputhje me kriteret e standardet të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë, në udhëzimet e MAS si dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë.			
Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë "Master profesional" përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	GVJ konstaton se në këtë program studimi është përcaktuar organizimi i praktikave profesionale. Këto praktika profesionale organizohen në përputhje me qëllimin dhe objektivat e këtij program studimi.			
Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	Ky program për momentin nuk përfshin elemente të mësimdhënies, module, lëndë në gjuhë të huaj; programi zhvillohet në gjuhën shqipe.			
Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimin të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	Kriteri 8 nuk aplikohet për këtë program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4

Programet e ciklit të dytë "Master profesional" janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	GVJ konstaton se UBT ka kapacitet njerëzor në fushën akademike në përshatje me qëllimin kryesor të këtij programi. Staf i FEA dhe DDA është staf me përvojë dhe i kualifikuar në fushat specifike që mbulojnë këtë program studimi. FEA, si njësi kryesore që ofron këtë program studimesh përbëhet nga 93 anëtarë staf akademik dhe 19 anëtarë staf ndihmës; DDA, njësi bazë përgjegjëse për këtë program ka 20 anëtarë staf akademik dhe 1 anëtar staf ndihmës. Nga shqyrtimi i dokumentave dhe vizita në Drejtorinë e Menaxhimit të personelit dhe pagave, sikurse dhe në takimet me stafin, u vu re që rekrutimi i stafit të ri

	bëhet sipas kriterëve të mirëpërcaktuara dhe akteve nënligjore në fuqi. Vlen të theksohet rekrutimi i vazhdueshëm i stafit të ri të diplomuar në këtë Institucion, por dhe të ardhur nga IAL të tjera.			
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim i Ndermarrjeve”, me profil “Menaxhim i Ndërmarrjeve të Agrobiznesit”, i ofruar nga DDA, pjesë e FEA në UBT, është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të këtij departamenti, që është njësia bazë e ofrimit të tij. Ky program është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet nënligjore në fuqi dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Konstatohet që emërtimi i këtij programi është vendosur në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit, që për këtë program përkon me nivelin 7 të saj.			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Kriteri 3 nuk aplikohet për këtë program			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.	Kriteri 4 nuk aplikohet për këtë program			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së	GVJ konstaton se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Master Profesional në “Menaxhim i Ndërmarrjeve”, me profil, njësia bazë përgjegjëse është DDA. Ky departament ka detyrën për të përmbushur qëllimin e programit. Departamenti

<p>përgjegjësi respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>mbulon me staf të kualifikuar shumicën e lëndëve/moduleve të programit, për pjesën tjetër angazhon staf nga departamentet e tjera të FEA.</p> <p>I gjithë procesi konstatohet që realizohet në mënyrë të koordinuar nga të gjitha hallkat (përgjegjëse dhe drejtuese) e strukturës (organigramës) së UBT, duke filluar nga Zv. Rektori për mësimin, Zv. Dekani i FEA, Përgjegjësi i Departamentit, Sekretaria e DDA, Zyra e Studimeve dhe Studentëve, Zyra e Kurrikulave në Rektorat. Në çdo vit akademik realizohet edhe një analizë e punës së tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe praktikave profesionale, GVJ konstaton se UBT ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe me organizata biznesi, të cilat ndikojnë në realizimin e objektivave të programit të studimit (referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit).</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>GVJ konstaton se në planin mësimor të këtij programi studimi praktika profesionale zë një vend të rëndësishëm, ajo kryhet në semestrin e katërt të këtij programi dhe ka qëllim që studenti të zbatojë njohuritë teorike në praktikë, të krijojë kontakte me tregun e punës, etj. Për realizimin e praktikës UBT ka marrëveshje me biznese e aktorë që operojnë në fushën e agrobiznesit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>Bashkëpunimi ndërmjet UBT dhe bizneseve për realizimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij programi studimi bëhet nëpërmjet marrëveshjeve por edhe me anë të kërkesave të veçanta. Gjithsesi, konstatohet se institucioni/biznesi ku studentët kryejnë praktikën është e lidhur me fushën e studimit detyrimisht. Ky bashkëpunim ndërmjet IAL dhe punëdhënësit të këtyre institucioneve/bizneseve, shkon përtej realizimit të praktikave profesionale, në punësimin e studentëve. (referuar rregullores së FEA, DDA, marrëveshjeve të bashkëpunimit aktive dhe vizitave në IAL)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>UBT ofron trajnime të ndryshme për studentët e diplomuar. Për këtë fillimisht bashkëpunojnë me punëdhënësit për të evidentuar fushat specifike të trajnimit.</p>
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Në fund të vitit departamenti DDA bën analizën e punës mësimore dhe shkencore ku përveç aspekteve të tjera të punës që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e këtij programi studimi, shqyrton dhe analizon marrëveshjet e bashkëpunimit. Në këto analiza evidentohen efektet pozitive dhe përfitimet e këtyre</p>

	marrëveshjeve në funksion të realizimit të qëllimeve të këtij programi studimi, por edhe të evidentimit të mangësive të tyre. GVJ konstaton se duhen bërë marrëveshje të reja bashkëpunimi dhe një angazhim më i madh si i stafit që merret me organizimin e këtyre praktikave, por dhe i punëdhënësve të këtyre bizneseve për të kontribuar më shumë për arritjen e qëllimit të bërjes së këtyre praktikave për studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Për programin e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” në “Menaxhim i Ndërmarrjeve”, me profil “Menaxhim i Ndërmarrjeve të Agrobiznesit”, UBT është mbështetur në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, për organizimin e lëndëve dhe shpërndarjen e tyre në grupet karakterizuese, të vlerësuara me kredite dhe orë brenda dhe jashtë auditorit/ kredit. Ky program studimi është i shtrirë në dy vite akademike, me katër semestra. Çdo vit akademik përkon me 60 kredite ECTS nga 30 kredite në semester. Ky program studimi është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat lidhen me fushën e studimit, emërtimin e programit, nivelin dhe kapacitetet akademike të njësisë ku zhvillohet ky program studimi. Programi i studimit detajohet sipas planit mësimor i cili përkthen çdo modul specifik në orë e kredite.

<p>Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>GVJ konstaton se kurrikula e programit përbëhet nga lëndë të formimit karakterizues, por edhe lëndë të karakterit integruar dhe lëndë me zgjedhje, sipas preferencave të tyre, të cilat i formojnë studentët, por dhe u krijojnë mundësinë atyre të fitojnë aftësi për të performuar në profesione si menaxher të ndërmarrjeve të inpleteve bujqësore dhe blegtorale, fermat bujqësore dhe blegtorale, sipërmarrjet e agrobiznesit, agjencitë shtetërore, sistemin bankar dhe mikrofinanciar, etj.</p>
<p>Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Synimi i programit të studimit Master Profesional në “Menaxhim i ndërmarrjeve” është të <i>përgatisë studentët me kompetenca dhe aftësi për menaxhimin dhe drejtimin</i> e ndërmarrjeve të inpleteve bujqësore dhe blegtorale, fermat bujqësore dhe blegtorale, sipërmarrjet e agrobiznesit, agjenci të ndryshme shtetërore në këto fusha. <i>Ata pajisen me aftësi për kuptimin dhe trajtimin kritik të problemeve në fushën e menaxhimit të ketyre bizneseve. Me lëndët që ofron ky program, jep njohuri të gjera në këtë fushë studimi dhe i përgatit për mundësi punësimi.</i> Programi i studimit arrin të aftësojë profesionalisht studentët në fushën e drejtimin të agrobiznesit, duke i pajisur me njohuritë themelore në këtë fushë nëpërmjet integritit të mësimin me praktikën.</p>
<p>Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ konstaton nga vizita në institucion se drejtuesit e institucionit por edhe pedagogët e lëndëve përkatëse angazhohen maksimalisht për të sjellë njohuri koherente pranë studentëve të programit. Kjo shprehet edhe në rinovimin e përvitshëm të syllabuseve dhe pasurimin e tyre me literaturë të përditësuar të viteve të fundit, e cila pasqyron njohuritë dhe risitë e kësaj fushe akademike dhe transmetimin e tyre tek studentët në auditor. Gjithashtu, GVJ, pasi shqyrtoi me kujdes Rregulloren e programit dhe dokumentat e tjerë (syllabuset, literaturën, etj.) konkludon se është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bie ndesh me interesat dhe programet e ofruara nga Institucione të tjera të Arsimit të lartë.</p> <p>Kurrikula e programit përbëhet nga lëndë të cilat synojnë ti pajisin studentët me aftësi dhe kompetenca profesionale. Syllabuset e lëndëve që përbëjnë këtë program studimi, në ndërtimin e tyre, e cila pasqyrohet tek temat e leksioneve që trajtohen gjatë zhvillimit të tij, transmetojnë një nivel të avancuar informacioni në këtë drejtim, i cili i aftëson studentët për zgjidhjen e problemeve komplekse në fushën e menaxhimit të ndërmarrjeve të agrobiznesit.</p>
<p>Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e</p>	<p>Pas shqyrtimit të kurrikulës së programit, syllabuseve të lëndëve/moduleve përbërëse, si dhe rregulloren e programit të</p>

<p>programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>studimit, GVJ gjykon që programi pasqyron elementët e përcaktuara në Ligjin “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Nr. 80/2015, datë 22. 07. 2015, (neni 33, pika 3), në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, VKM Nr. 41 datë 24.01.2018. , në Statutin e Universitetit Bujqësor të Tiranës (më poshtë UBT), në rregulloren e brendshme të UBT_s, në rregulloren e FEAS, në rregulloren e studimeve DDA, vendimet e Senatit të UBT_s.</p> <p>Kontrolli i dijeve kryhet me anë të detyrave/projekteve të kursit individual ose në grup dhe provimeve të ndërmjetme dhe forma të tjera të cilat janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në syllabuset e lëndëve/moduleve. Sipas pikës 2, neni 35, në Rregulloren e DDA: “Programi i studimit “Master Profesional” në DDA është i organizuar me 120 kredite formimi, në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje dy vite akademike”.</p>			
<p>Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit është i ndarë në module dhe lëndë në mbështetje të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Gjithashtu kreditet (ECTS) specifikohen në përputhje me raportin e orëve teori/praktikë.</p>			
<p>Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p>	<p>Ky program studimi parashikon ngarkesën në kredite për modulet dhe për praktikën profesionale. Praktika profesionale është e detyrueshme dhe realizohet në semestrin e katërt, me 20 kredite, sipas planit mësimor. Lëndët janë secila me nga 5 kredite. Praktika profesionale është pjesë e lëndëve plotësuese sipas kategorizimit të lëndëve të përcaktuara në VKM Nr. 41 datë 24.01.2018.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi është DDA. Institucioni ka kaluar procesin e akreditimit institucional sipas parashikimeve të ligjit 80/2015. Programi i studimit po i nënshtrohet vlerësimit në kuadër të akreditimit të tij të parë. Gjithashtu njësia e sigurimit të cilësisë që vepron në nivel Institucioni garanton cilësinë në procesin mësimor.</p>

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit ka në përbërje të tij 20 anëtarë staf akademik efektiv dhe 1 staf ndihmës akademik.</p> <p>Kualifikimi i stafit akademik i DDA-së paraqitet si vijon: 4 Profesor, 8 Profesorë të Asociuar, 6 Doktor dhe 2 Master, që është në përputhje me Ligjin 80/2015 dhe aktet nënligjore.</p> <p>Në programin e studimit janë angazhuar 21 staf akademik efektiv, të cilët janë staf akademik edhe nga departamente të tjera të FEA-s, dhe rezulton që kualifikimi i të gjithë stafit akademik të angazhuar në të është si vijon: 7 Profesor, 9 Profesor të Asociuar, 5 Doktor.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Nga studimi i dokumentacionit evidentohet që ngarkesa për vitet akademike 2017-2018 dhe 2018-2019 mbulohet në 100% nga staf akademik efektiv.</p> <p>Nga takimet në institucion u theksua që në raste kur nuk përmbushen nevojat me personel akademik efektiv, DDA angazhon sipas nevojave vjetore edhe staf akademik me kontratë. Planifikimi për staf akademik të ftuar bëhet në fillim të çdo viti akademik dhe miratohet nga Dekanati dhe nga Rektorati. Në çdo rast, ngarkesa që mbulohet përgjatë një viti akademik nga stafi efektiv është gjithmonë më e madhe se ajo e stafit akademik të ftuar.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Nga vizita në Institucion rezulton se ka një personel të mjaftueshëm akademik dhe ndihmës akademik i cili mundëson zhvillim normal të procesit të mësimdhënies si edhe realizimin e shërbimeve ndaj studentëve, sidomos në rastet e lëndëve në të cilat ka praktikë mësimore, ku krahas pedagogut të lëndës asistojnë edhe stafi ndihmës akademik. Në FEA ka tre staf ndihmës akademik, secili përgjegjës për dy salla laboratorie, të cilët angazhohen dhe në këtë program studimi për lëndë të veçanta.</p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> <p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>	<p>Përgjegjësi i departamentit luan rolin e koordinorit dhe zbatuesit të programit të studimit nën shqyrtim, e përcaktuar dhe në rregulloren e brendshme të DDA. Ai drejton të gjithë veprimtarinë mësimore dhe shkencore, kontrollin e tij si dhe realizimin e praktikave profesionale në përputhje me objektivat e caktuara.</p> <p>Përgjegjësi i departamentit raporton në lidhje me ecurinë e programit, aspektet pozitive, problemet si edhe masat e marra për zgjidhjen e tyre në mbledhje departamenti si dhe informon në vazhdimësi Dekanin e FEA për ecurinë e zbatimit të programit.</p> <p>Të gjitha informacionet dokumentohen nga përgjegjësi i departamentit që është dhe koordinori i programit të studimit në departament dhe informacioni kalon dhe tek Dekani.</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit ka informacionin e nevojshëm dhe mbështetet në Rregulloren e Brendshme të FEA dhe Rregulloren e programit të studimit Master profesional në “Menaxhim i Ndërmarrjeve”, me profil “Menaxhim i Ndërmarrjeve të Agrobiznesit” për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. (Ref. Aneksi B.8 Kurrikula e programit të studimit) Nga analiza e kurrikulës së programit të studimit, evidentohet që kjo kurrikulë është në përputhje me VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018, pika 2.6.
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	DDA/FEA ka organizuar programin e studimit nën shqyrtim bazuar në VKM Nr .41, datë 24.01.2018 “Për Elementët e Programeve të Studimit....”. Kurrikula e programit të studimit është në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Programi i studimit është i ndarë në dy vite studimi me 4 semestra ku secili semestër ka 15 javë mësimore. Në semestrin e katërt realizohet praktika mësimore dhe përgatitet punimi i diplomës. Në semestrin e parë janë 6 module, 5 module të detyrueshme dhe 1 modul me zgjedhje në të cilën student pajiset me kompetenca profesionale përcaktuese, ndërsa kompetencat profesionale specifike merren nga studenti në semestrin e dytë dhe të tretë, respektivisht në 6 module secili (5 module të detyrueshme dhe 1 modul me zgjedhje).
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Kurrikula e programit të studimit është e organizuar në lëndë e module, të cilat janë të vlerësuara me kredite ECTS ku 1 ECTS = 25 orë mësimore punë e studentit. Një vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor, një semestër ka 15 javë mësimore në auditor, një orë mësimore zgjat 50 minuta. Ky program është me 120 ECTS, i organizuar në 4 semestra. Tre semestra kanë nga 6 module me nga 5 ECTS secila, ndërsa semestri i katërt i dedikohet tërësisht realizimit të praktikës profesionale (20 ECTS) dhe përgatitjes për provimin final/punimin e diplomës (10 ECTS). Këto informacione janë të detajuara në Rregulloren e programit të studimit dhe në Rregulloren e FEA dhe Aneksi B.8 “Kurrikula e

	programit të studimit MP në MNAgrobiznesit”.
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Programi i studimit bazohet në planin mësimor, i cili përbën dokumentin kryesor për zbatimin e këtij programi, i cili hartohet nga përgjegjësi i njësisë bazë, miratohet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i UBT. Ai pasqyron informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. (referuar Aneksit B.3: “Plani mesimor dhe struktura mësimore”)
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	GVJ konstaton se ndiqen procedura transparente përsa i përket kriterëve të përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Këto informacione pasqyrohen në Rregulloren e programit të studimit, e cila bazohet gjithashtu në Rregulloren e institucionit dhe Rregulloren e FEA dhe specifikisht në Aneksin A.11 “Rregullorja e programit të studimit MP në Menaxhimi i ndermarrjeve të agrobiznesit” dhe Aneksin A.19 “Rregullore e brendshme e DDA”2017, Kreu 1 dhe “Programet e studimit”, Neni 69-72. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit bëhet publik në faqen e internetit, broshurën informuese etj. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ evidentoi një procedurë normale transferimi, ku për pranimin e studentëve të transferuar institucioni ngre një komision ad hoc nga departamenti, i cili bën dhe ekuivalentimin e lëndëve.
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Syllabuset e lëndëve të programit nën shqyrtim përmbajnë informacion të detajuar për leksionet, praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, dhe janë hartuar në përputhje me formatet ligjore të përcaktuara. Procedura e hartimit të tyre kalon nga titullari i lëndës/modulit, shqyrtohet në departament dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit dhe Dekani i fakultetit. Syllabuset përmbajnë informacione të përgjithshme si: titulli i lëndës/modulit, titullari, ngarkesa në orë dhe kredite, tipologjia e lëndës (kategoria), viti dhe semestri kur zhvillohet lënda, lloji i lëndës, programi mësimor të cilit i përket, kodi i lëndës, temat e lëndës, mënyrën e kontrollit të dijeve të lëndës. GVJ verifikoi që syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi përmbajnë të gjithë elementët sipas përcaktimeve VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018. Programi i studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. DDA në fillim të çdo viti akademik, diskuton

	<p>përmbajtjen e programeve të studimit dhe problematikat e hasura. GMK miratojnë të gjithë syllabuset. Ato pas miratimit janë reflektuar në të gjithë elementët e dosjes së programit të studimit. Nga takimet me stafin konstatuam që çdo vit, ata ndryshojnë, përmirësojnë programet e lëndëve të tyre për ti përshtatur me ndryshimet e tregut të punës. Të gjitha syllabuset arkivohen në departament në kopje digjitale dhe në hardcopy.</p> <p>(Aneksi B.73 “Kurrikula e programit të studimit MA në MNAB, 2014-2019” dhe vizites në IAL).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e programit të studimit është e strukturuar në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor për programin e studimit Master Profesional në “Menaxhimi i Ndërmarrjeve të Agrobiznesit”, është 24 orë mësimore 50-minutëshe e mbështetur në VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018. Pra, ngarkesa javore është në përputhje me parashikimet nënligjore në fuqi.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, mundësojnë një thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme të studentëve dhe për punësimin e tyre.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Modulet e kurrikulës së programit të studimit rezultojnë që janë organizuar në mënyrë të tillë që studenti të ketë një ngarkesë të njëjtë përgjatë të tri semestrave të parë. Kjo si në aspektin e ngarkesës mësimore ashtu edhe në lidhje me kreditet për çdo modul. Raporti i orëve është për të gjithë modulet 2x2 ndërkohë që çdo modul ka 5 kredite. Ngarkesa në kredite për çdo semestër është 30 ECTS. Nga takimi me studentët e pedagogët, kuptuam që kjo mënyrë e shpërndarjes mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor dhe e objektivave të programit të

	<p>studimit. Ndarja e lëndëve me karakter formues dhe aplikativ në semestrin e parë krijon mundësinë për të thelluar njohuritë teorike të marra nga cikli i parë i studimit dhe paralelisht mundëson aftësimin gradual e praktik në semestrin e dytë e të tretë. Mundësia për të realizuar 2 orë në javë seminar, krijon mundësinë që studenti të analizojë çështjet e leksionit si edhe të punojë në mënyrë të pavarur detyra kursi në funksion të temave studimore, apo edhe të realizojë prezantime, detyra etj.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Struktura e programit të studimit Master Profesional në “Menaxhimi i Ndërmarrjeve”, me profil “Menaxhimi i Ndërmarrjeve të Agrobiznesit” është unike për Shqipërinë për vetë profilin që ajo ofron dhe tenton të mbulojë nevojat në tregun e punës. Natyra e moduleve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike të informacionit që jep një modul dhe aplikimeve të mundshme praktike. Eksperiencat ndërkombëtare të ndjekura në hartimin e kurrikulës së këtij programi studimi kanë ndihmuar studentët në njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës së tyre.</p> <p>Gjithashtu, ky program i ka krijuar mundësi studentëve të transferojnë studimet, pasi përmbajtja është e krahasueshme me dijet që studenti mund të marrë në institucione të tjera brenda apo jashtë vendit. FEA në bashkëpunim me DDA bën ekuivalentimin e moduleve ose programeve të plota të studimit ose diplomave të marra në institucione të tjera të vendit ose të huaja mbas paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit të nevojshëm nga të interesuarit. Gjithashtu departamenti është bashkëpunues me studentët për të lehtësuar praktikat dhe procedurat e njohjes së plotë apo të pjesshme të lëndëve që studentët mund të kenë realizuar në programe të mëparshme. Procedura fillon me paraqitjen e kërkesës së studentit. Studenti duhet të depozitojë programin e lëndës që ka zhvilluar në një program tjetër në një institucion tjetër dhe më pas vlerësohet përputhshmëria e programeve duke konkluduar me një vendim. Në rastin kur kërkesa e studentëve vjen për lëndë që zhvillohen brenda Universitetit studenti paraqet vetëm kërkesën për njohje të lëndës dhe vlerësimi i përputhshmërisë së programeve realizohet nga fakulteti. Midis viteve 2014-2019 nuk rezulton të jetë bërë ndonjë transferim në këtë program studimi. Po në këtë periudhë janë çregjistruar 7 studentë.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p> <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton</p>	<p>FEA dhe DDA analizojnë mbi bazë fakulteti dhe departamenti, ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në to mendimin dhe opinionin e lektorëve por edhe të studentëve duke bërë një pyetësor pas çdo moduli nga vetë pedagogët lidhur dhe me programin e çdo moduli. Bazuar në opinionet dhe mendimet e</p>

përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.	marra, DDA programon politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit duke përfshirë këtu edhe ndryshime të mundshme të syllabuseve sipas moduleve.			
	Programi është ndërtuar mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit, dhe thëllon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura. Studentët vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme, duke u dhënë mundësi të plotësojnë njohuritë dhe të sqarojnë paqartësitë gjatë semestrit. Studentët në këtë cikël studimesh marrin njohuri më të avancuara në fushën e menaxhimit e marketingut si dhe kompetenca të mbledhjes së të dhënave.			
Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi i studimit i pajis studentët me njohuri të thelluara teorike me aftësi praktike, me aftësi për kërkim shkencor dhe i trajnon për profesionin.			
Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit mundëson punësimin në sektorin publik e privat të Agrobiznesit apo edhe në sektorë të tjerë të ekonomisë por sigurisht edhe në institucione kërkimore dhe politikëbërëse. Në komunikimet me stafin dhe studentët rezultojnë shumica e studentëve që kanë mbaruar këtë program studimi janë të punësuar si në sektorin privat dhe në atë publik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Në realizimin e programit të studimit janë angazhuar 21 pedagogë, nga të cilët 7 Profesorë, 9 Profesorë të Asociuar dhe 5 Doktorë, pra me kualifikim më të lartë se cikli i studimit ku janë të angazhuar në mësimdhënie. Staf i angazhuar në programin e studimit është i gjithi staf efektiv, i DDA dhe departamenteve të tjera të FEA.
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për	Nga vizita në Institucion dhe analiza e RVB dhe dokumenteve të ofruara nga IAL, konstatohet që Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA) bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta dhe të ndërthurura njëra me tjetrën,

<p>drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p> <p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>duke ofruar programe studimi në 3 cikle studimi. FEA organizohet në 6 njësi bazë. Organizimi dhe funksionimi i tyre është i parashikuar në statutin e UBT-së. Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit, ka në përbërje të tij 20 anëtarë staf akademik efektiv dhe 1 staf ndihmës akademik. Personeli akademik me kohë të plotë dhe më kohë të pjesshme që angazhohet në mësimdhënie në programin e studimit Master Profesional në “Menaxhimi i Ndërmarrjeve të Agrobiznesit” plotëson të gjitha kërkesat ligjore në fuqi. I gjithë ky personel është i kategorisë Profesor dhe Doktor, pra me gradë më të lartë sesa cikli i studimit ku janë të angazhuar në mësimdhënie. Respektivisht, në programin e studimit janë të angazhuar 7 Profesorë, 9 Profesorë të Asociuar dhe 5 Doktorë. Duhet theksuar se i gjithë stafi pedagogjik i angazhuar në mësimdhënie në ciklin master profesional në “Menaxhim i Ndërmarrjeve të Agrobiznesit” është me kohë të plotë. Ky staf i përket DDA-s dhe departamenteve të tjera të FEA-s.</p> <p>Përveç personelit akademik efektiv, DDA angazhon sipas nevojave vjetore dhe staf akademik me kontratë. Planifikimi për staf akademik të ftuar bëhet në fillim të çdo viti akademik dhe miratohet nga Dekanati dhe nga Rektorati. Në çdo rast, ngarkesa që mbulohet përgjatë një viti akademik nga stafi efektiv është gjithmonë më e madhe se ajo e stafit akademik të ftuar. Për vitet akademike 2017-2018 dhe 2018-2019, ngarkesa mësimore mbulohet në 100% nga staf akademik efektiv. Në këtë program studimi nuk ka staf akademik të ftuar pasi nevojat mbulohen nga stafi akademik i brendshëm.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka një angazhim të përshtatshëm të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e qëllimeve formuese të programit siç mund të jetë kërkimi i pavaruar i burimeve nëpërmjet sistemit online të bibliotekës. Studentët asistohen nga stafi i bibliotekës nën drejtimin e punës nga lektori i lëndës. Në rastin e këtij programi studimi, studentët kryejnë praktikë mësimore në lëndën “Sistemet e Informacionit të Drejtimit”. Gjatë këtyre orëve krahas pedagogut të lëndës asistojnë edhe stafi ndihmës akademik. Nga ana e Institucionit rezulton se ka një personel të mjaftueshëm akademik dhe ndihmës akademik i cili mundëson zhvillim normal të procesit të mësimdhënies si edhe realizimin e shërbimeve në ndaj studentëve. Në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit në Universitetin Bujqësor të Tiranës funksionojnë 6 laboratorë të cilët përdoren nga studentët për kryerjen e praktikave laboratorike në lëndë të caktuara. Në FEA janë gjithsej tre staf ndihmës akademik, secili përgjegjës për dy salla laborator.</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi II.6				
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Komisioni i Kurrikulës gjykon nëse programi i studimit (i përmirësuar) plotëson kërkesat e Universitetit, është i krahasueshëm me programe të ngjashme të ofruara edhe në vende të tjera apo në Shqipëri dhe nëse kurrikula ofron një përvojë të vlefshme për studentët. Ky komision është i përbërë nga profesorë me përvojë të njësisë kryesore dhe zbaton me përpikmeri kriteret e shkruara në Manualin e Cilësisë së UBT, 2018.			
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	UBT inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Ngrihen grupe pune ku në përbërje ka dhe studentë dhe profesionistë të fushës jashtë universitetit, bëhet një analizë SWOT e kurrikulës ekzistuese, dakorësohen sugjerimet për kurrikulën nga komisioni, propozimet diskutohen dhe reflektohen në funksion të përmirësimit të programit të studimit, merr miratimin nga Departamenti, Dekanati, Rektorati dhe Senati.			
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	UBT përditëson në mënyrë të vazhdueshme dhe riorganizon programe në përputhje me vizionin strategjik të zhvillimit të ekonomisë shqiptare në përgjithësi dhe fushës së bujqësisë dhe ekonomisë bujqësore në veçanti. Këto rregullime bëhen në përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit të vendit.			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	UBT përditëson në mënyrë të vazhdueshme dhe riorganizon programe në përputhje me vizionin strategjik të zhvillimit të ekonomisë shqiptare në përgjithësi dhe fushës së bujqësisë dhe ekonomisë bujqësore në veçanti. Këto rregullime bëhen në përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit të vendit.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	UBT ka hartuar një plan masash në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. (Aneksi A.5 Udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies). Zbatimi bëhet nga zyrat e Rektoratit, Dekanatet dhe Departamentet përkatëse.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Shqyrtimi i akteve të brendshme të UBT si dhe i dosjeve personale të pedagogëve nxjerr në pah se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit është aktiv në publikimin e artikujve dhe materialeve shkencore. Puna kërkimore dhe botimet lidhen me fushën kryesore të studimit të këtij programi. Puna kërkimore e personelit akademik synon në përpunimin e mendimeve për zhvillimin e studimeve në fushat e menaxhimit të ndërmarrjeve që përfshihen në programin e studimit dhe më tej, dhe kjo monitorohet dhe evidentohet me dokumentin e performancës akademike. Monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik monitorohet në mënyrë periodike nga UBT/FEA. Si instrumente përdoret pyetësi me studentët i cili realizohet 2 herë përgjatë vitit akademik dhe rezultatet e anketimit të përpunuara nga një grup pune me përfaqësues nga dekanati dhe departamenti bëhen pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore. Gjithashtu, në fund të çdo viti akademik, stafi akademik efektiv në bashkëpunim me titullarët e grupeve kërkimore shkencore dhe Drejtuesit të Departamentit plotëson Dokumentin e Normimit të Procesit të Mësimdhënies.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	GVJ konstaton se studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve nëpërmjet anketave dhe pyetësorëve. DDA mundëson dhe trajtimin e ankesave dhe ankimimeve nga ana e tyre. Nga vizita në institucion u vu re që anketa me studentët është një nga format e vlerësimit periodik të metodave të mësimdhënies dhe dijeve. (Aneksi B.18 Modeli i anketës së studentëve).

<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse (njësia bazë dhe kryesore) bëjnë publike rezultatet në analizën vjetore të njësisë. Këto rezultate fillimisht diskutohen në një mbledhje të hapur departamenti. Vetëm pas diskutimeve në Departament dhe reflektimeve të ndryshme lidhur me problematikat e gjetura, kjo analizë miratohet dhe përcillet në Dekanat.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Të dhënat, bashkë me komentet e studentëve (të hedhura në në database në Excel dhe të përpunuara) paraqiten në një raport të bërë nga Departamenti dhe më pas edhe në raportin e Dekanatit. Rastet e specifikuar si pozitive nga studentët bëhen të ditura në mbledhjet e departamentit. Nga vizita në institucion u vu re që këto rezultate nuk u bëhen publike studentëve dhe masat e marra nuk bëhen publike.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Format e mësimdhënies, mësimnxënies e transmetimit të njohurive përfshijnë: leksione, seminarë/orë laboratorike, detyra/projekte kursi, praktikë profesionale, tema diplome/provim formimi. Në këtë program studimi orët/kreditet për secilën formë të dhënë janë: 540 orë leksione, 540 orë seminarë (totali 1080 orë - 90 kredite), 20 ECTS praktikë profesionale, 10 ECTS temë diplome/provim formimi (totali 120 kredite).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve janë të paraqitura në syllabuset dhe programet e lëndëve e moduleve. Format e mësimin teoritik e praktik janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit/projektet e kursit, etj. Format e kontrollit të dijeve janë testimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe e projekteve të kursit, mbrojtja e praktikave profesionale, provimet e kursit. Provimi i formimit bëhet me mbrojtje të temës së diplomës ose provim.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në</p>	<p>Personeli akademik mbështetet nga institucioni për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave. Sallat e informatikës të pajisura me kompjutera në funksion të moduleve dhe pajisja e çdo salle leksioni të Fakultetit me projektorë, ndihmojnë procesin e mësimdhënies e mësimnxënies në përputhje me objektivat</p>

përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	formuese dhe kërkesat aktuale të punëdhënësve.			
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Titullarët e lëndëve në programin e studimit, për vitin akademik 2018-2019, janë 7 me titullin “Profesor”, 9 me titullin “Profesor i Asociuar” dhe 5 me gradën “Doktor”. Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit “Master Profesional” plotëson të gjitha kriteret ligjore të kualifikimit. Autoritetet drejtuese rezultojnë me tituj akademik, duke qenë të angazhuar me kohë të plotë në Institucion. Për lëndët dhe modulet ekzistojnë tekste, leksione dhe materiale të tjera që u vihen në dispozicion studentëve, edhe nëpërmjet librarisë, por jo gjithmonë. Pedagogët kanë site personale, në të cilat studentët mund të marrin dhe leksionet në poëer point dhe raste studimi, por dhe materiale të tjera mësimore.			
Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Institucioni i jep rëndësi zhvillimit me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve. Kontrollat e vazhdueshme dhe leksionet e hapura të organizuara nga dekanati dhe departamenti identifikojë problemet që duhen përmirësuar dhe vlerësojnë arritjet. Pjesë e reflektimit dhe organizimit të leksioneve të hapura janë edhe rezultatet e marra nga pyetëtori i studentëve.			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin. Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtime të marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Orët e mësimin janë interaktive, ku studentët bashkëveprojnë me pedagogët dhe njëri-tjetrin, sidomos në orët e seminareve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen

Procesi mësimor për programin e studimeve zhvillohet pranë ambienteve të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit të ndara në dy godina kryesore: - Godina A, e cila është e organizuar në 2

rregullisht.	kate dhe ka në përbërje të saj: • 7 Salla leksionesh • 14 salla seminaresh, • 5 laboratorë për zhvillim e lëndëve të ndryshme si Informatikë, Statistikë, Ekonometri, Kontabilitet, etj. - Godina B është e organizuar në 4 kate dhe ka në përbërje të saj: • 8 Salla leksionesh, • 23 salla seminaresh, • 2 laboratorë për zhvillim e lëndëve të ndryshme si Informatikë, Statistikë, Ekonometri, Kontabilitet, etj. Në këtë godinë është i pozicionuar edhe Dekanati i FEAs. Të dy godinat janë të mirëmbajtura.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	Nga konstatimi u vu re që ambientet e FEAs janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit “Master Profesional” në departamentin “Drejtimit Agrobiznesi”. Këto ambiente përfshijnë salla, zyra, laboratorë. Sallat dhe laboratorët janë të pajisura me mjetet e nevojshme të përshtatshme për mësimdhënie si kompjutera (desktop, laptop), videoprojektorë, lidhje interneti, etj. Nga ana tjetër, ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”, sipas të cilit kërkohen 2.5 m ² / student.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Realizimi i seminareve dhe praktikave në module të caktuara organizohet në laboratorët kompjuterikë. Studentët e të gjitha cikleve të studimit në FEA në përgjithësi dhe ata të DDA-së në veçanti, shfrytëzojnë të gjitha ambientet e mëposhtme: - 5 salla kompjuterash (rreth 25 kompjutera secila sallë). Këto salla janë rezultat i projekteve të ndryshme ndërkombëtare koordinuar nga anëtarë të stafit akademik të FEA-s. - 2 salla të reja laboratorike të ngritura prej shtatorit 2017, një investim i universitetit me fondet e veta. Të gjitha këto salla janë të pajisura me softëare specifike që ndihmojnë në realizimin e punës së pavarur të studentëve.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë për çdo modul të ofruar në këtë program studimi ofrohet në gjuhën shqipe. Baza mësimore përfshin tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt. Materialet fizike ofrohen në librarinë e UBT-së apo në librarinë e FEAs. Materialet e tjera si p.sh ppt. të leksioneve janë të vendosura në shtet personale të pedagogëve. Sipas RVB, Institucioni zotëron edhe librari elektronike me akses në disa prej revistave më të mira, por nga vizita në Bibliotekë rezultoi se nuk mund të aksesoheshë në to.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të	UBT/FEA vë në dispozicion të studentëve nëpërmjet bibliotekave të vendosura në mjediset e universitetit dhe FEA-s, tekstet mësimore të përcaktuara në syllabuse-t e lëndëve dhe

mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	literaturë ndihmëse të nevojshme, përzgjedhur mbi bazë të planit të hartuar nga përgjegjësi i programit. Fondi i bibliotekës, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, pasurohet në mënyrë të vazhdueshme, duke synuar reflektimin e ndryshimeve cilësore të programit të studimit si edhe azhornimin me zhvillimet më të fundit të literaturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Nga vizita në Institucion rezultoi që biblioteka nuk përdoret shumë nga studentët.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Biblioteka ka një sallë të pajisur me 12 kompjutera të lidhur me internet, nëpërmjet të cilëve mund të shfrytëzohet fondi online TEEAL dhe burime të tjera online pa pagesë, p.sh., Google site; MOODLE, Research4life, me pesë programet Hinari, AGORA, OARE, ARDI, GOALI). Libraria on-line TEEAL që zotëron IAL, nga vizita në bibliotekë rezultoi që nuk ishte e aksesueshme.
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Përveç laboratorëve dhe sallave, në dispozicion të studentëve të doktoraturës dhe jo vetëm, ka dhe dy salla të tjera, njëra produkt i një projekti IPA dhe tjetra produkt i një projekti TEMPUS, të dyja të koordinuara nga dy anëtarë të stafit të DDAsë. Njera përdoret më së shumti për mbrojtjen e dizertacioneve para jurisë dhe prezantime të ndryshme në kuadër të promovimit të stafit akademik.
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Përdorimi i platformës on-line është aplikuar në kuadër të projektit Tempus, për studimet doktrature, me tematikë “Sipërmarrja dhe Menaxhimi i SME-ve”, financuar nga Komisioni Europian. Është zhvilluar në formatin e-learning moduli “Small Business Marketing Strategies”. Moduli “Njohuria e Informacionit” është i aksesueshëm lirshëm online për të gjithë stafin akademik dhe studentët e UBT. Moduli online është në gjuhën shqipe dhe është rezultat i bashkëpunimit në kuadrin e një projekti TEMPUS. Linku: http://ubt.edu.al/albagt_final/albagt_start.html
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Të gjithë pedagogët e angazhuar në mësimdhënie kanë site-in e tyre dhe kjo bën të mundur dhe komunikimin pedagog – student. Në to studentët kanë akses në leksione, syllabusin e modulit, strukturën dhe mënyrën e administrimit të modulit. Ata mund të marrin gjithashtu dhe informacion rreth backgroundit të pedagogut nëpërmjet CV të këtij të fundit.
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Në përfundim të studimeve, studentët e ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional” me mesatare note nga 6.5 e lart mund të paraqesin një punim diplome në Drejtim/Menaxhim Agrobiznesi. (mbeshtetur në rregulloren e programit të studimit). Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temës bazuar në fushat e kërkimit që mbulon departamenti. Në përfundim të

	<p>semestrin të tretë, studentët në bashkëpunim dhe me miratimin e udhëheqësit potencial të diplomës plotësojnë një formular ku specifikojnë fushën e studimit/titullin potencial të temës. Departamenti përcakton kriteret dhe standardet e përgatitjes së një punimi diplome të nivelit të dytë “Master Profesional”. Udhëheqësi i punimit të diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studentit dhe pedagogu. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studentit dhe lejon mbrojtjen e tij duke e firmosur atë. Të gjitha keto detyrime dhe afate i vihen në dispozicion paraprakisht studentit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në funksion të procesit mësimor – kërkimor, institucioni ka organizuar struktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e mësimdhënies. Njësitë ndihmëse në funksion të procesit mësimor-kërkimor janë: 1. Sektori i Mësimin, Kurrikulave & Vlerësimit Institucional, 2. Sektori i Kërkimit, Koop. Shkencor & Projekteve Sektori i Informacionit & Transferimit të Njohurive. 3. Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë & Publikun i cili përbëhet nga: a) Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, dhe b) Zyra e Marrëdhënieve me Publikun. Sektorët janë të pajisur me rregullore të miratuara nga Senati i UBT-së.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Nga analiza u vu re që për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, Fakulteti dhe Departamenti, në koordinim me njëra-tjetrën, organizojnë në mënyrë periodike, leksione të hapura në dy drejtime: 1. Stafit i ri ndjek orë leksionesh nga stafit më me përvojë; 2. Stafit i ri asistohet gjatë orëve të hapura nga titullarët e modulit si dhe nga përfaqësues të departamentit dhe fakultetit.</p>

<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Për zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies ndiqet si praktikë leksionet e dhëna nga lektorë të huaj. Këta lektorë mund të jenë personalitete të fushës në Shqipëri por edhe lektorë të ftuar nga programet ERASMUS+ nga universitete perëndimore. Të gjitha këto shkëmbime eksperience i shërbejnë ndër të tjera edhe rritjes së vetëdijes së personelit akademik dhe studentëve për cilësinë e mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga konstatimet u vu re që në DDA i kushtohet një vëmendje kualifikimit të stafit, që çon më pas në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Stuktura e kualifikimit të stafit për 2 vitet e fundit akademike paraqitet paksa më ndryshe krahasuar me vitin akademik 2016 -2017 ku në përbërje të tij kishte përveç numrit të njëjtë të anëtarëve me titullin “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar”, 6 anëtarë me gradën “Doktor” dhe 1 me titullin “Master i Shkencave”.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe i dosjeve personale të pedagogëve vihet re se personeli akademik i angazhuar në këtë program është aktiv në publikimin e artikujve dhe materialeve shkencore. Puna kërkimore dhe botimet lidhen me fushën kryesore të studimit të këtij programi.</p> <p>Puna kërkimore e personelit akademik synon në përpunimin e mendimeve për zhvillimin e studimeve në fushat që përfshihen në programin e studimit dhe më tej.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik DDA është trajnuar me qëllim përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe përdorimin e metodave të reja në mësimdhënie. Trajnimet janë zhvilluar në kuadër të projekteve të ndryshme të bashkëpunimit / marrëveshjeve që institucioni ka me institucione të tjera publike. Disa nga këto trajnime me target group stafin akademik kanë qenë: - “Grant Writing” dhe “Prioritization Settings” organizuar nga projekti AHEED (Albania Higher Education and Economic Development). - Trajnimi nga Projekti DOSMEC në lidhje me e-learning.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Në rastin e personelit ndihmës akademik përmendim trajnimet në kuadër të projekteve Consuss dhe E- library për punonjësit e bibliotekës së UBT. Fokusi i këtyre trajnimeve ka qenë organizimi dhe sistemimi i informacionit akademik. Ka qenë dhe është në përgjegjësinë e personelit akademik të trajnuar që të transmetojë metodat dhe praktikat e reja të marra gjatë trajnimit tek studentët, duke qenë se është pikërisht ky personel përgjegjës për realizimin e programit të studimit. P.sh. njohuritë e marra gjatë trajnimit “Grant Writing” dhe “Prioritization Settings” janë transmetuar tek studentët e ciklit të dytë të studimeve nëpërmjet modulit “Metodologji Kërkimi”. Këto metoda të reja por edhe të</p>

	tjera të fituara në kuadër të trajnimeve të ndryshme janë transmetuar tek studentët dhe këto njohuri kanë rezultuar të jenë me vlerë dhe metodat të jenë të suksesshme.			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Gjatë vizitës në institucion dhe bisedat e zhvilluara me pedagogët u konstatua qartë vullneti i FEA për t'u siguruar atyre si informacionin e nevojshëm për programe të ndryshme studimi, me qëllim kualifikimi, brenda dhe jashtë vendit, por dhe organizimi i programeve të caktuara nga vetë institucioni. Vetë institucioni ka realizuar zhvillimin e një sërë aktiviteteve me natyrë shkencore të tilla si, konferenca, seminare, leksione të hapura me lektore të huaja dhe personalitete të fushës, ku është nxitur pjesëmarrja e personelit akademik. Nga bisedat e zhvilluara, doli në pah vullneti institucional për të fituar disa projekte të rëndësishme, në të cilët është aplikuar. Nga bisedat e bëra me pedagogët, por dhe nga aktet e brendshme të institucionit, rezultoi më së miri se ky i fundit u ka krijuar lehtësi nga më të ndryshme për të kryer kualifikime brenda dhe jashtë vendit. Disa pedagogë vazhdojnë studimet doktorale jashtë vendit.			
Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	Nga analiza e RVB dhe vizita në institucion rezultoi se UBT ka një sërë marrëveshesh bashkëpunimi e partneriteti me institucione të ngjashme nga vende të ndryshme të rajonit dhe Evropës. Bashkëpunimi dhe partneriteti midis stafëve akademike jo vetëm që rrit nga pikëpamja e cilësisë performancën e stafit akademik por dhe ngre në një nivel më të lartë transmetimin e dijeve tek studentët (praktika të reja mësimdhënie, potencialisht mjete të reja mësimdhënie, metoda të reja të përfshirjes së studentëve në diskutim (interaktivitet më intensiv). Pedagogët të DDA-së disa prej të cilëve të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit "Master Profesional" kanë lëvizur në kuadër të Projekteve Erasmus + & Erasmus Mundus.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen	Për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, me fokus parësor aftësimin e studentëve, rezultoi nga dokumentacioni si dhe nga vizita në institucion, përdorimi i metodave të efektshme të

<p>nga studentët.</p> <p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> <p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>vlerësimit të dijeve të studentëve. Konkretisht, në përputhje me parashikimet në syllabuse, metodat e vlerësimit përfshijnë testimet, detyra kursi, teste me alternativa përgjigjesh si dhe provime përfundimtare me gojë e shkrim. Format e kriteret e vlerësimit të dijeve për studentët përcaktohen qartësisht në nenin 57 të Rregullores së Studimeve të UBT. Kështu, format e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve të përvetësuara nga studenti gjatë orëve teorike dhe praktike mësimore përfshijnë testimin e ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, projekte apo detyrat e kursit, esetë dhe provimin final. - Detyrat e kontrollit janë elementë të vlerësimit të vazhduar të nivelit të dijeve. Këto organizohen vetëm me shkrim në javën e tetë të çdo semestri, mbi bazë grupi mësimor dhe vetëm gjatë orëve të planifikuara për seminare. - Provimi final organizohet a) me shkrim, b) me gojë, c) i kombinuar (me shkrim e me gojë). Është përgjegjësi e departamentit të përcaktojë nëse pjesa me shkrim e provimit është përcaktuese apo eliminuese. Provimi final organizohet dhe përfundon në datën dhe orarin e përcaktuar në grafikun e provimeve i cili hartohet nga Zv. Dekani për mësimin në bashkëpunim me përgjegjësat e departamenteve dhe miratohet nga Dekani. Grafikët e provimeve shpallen jo më vonë se katër javë para fillimit të sezonit. Të gjitha format e kontrollit të dijeve u bëhen me dije studentëve në fillim të procesit mësimor Zakonisht në orën e parë të seminarit studentët marrin informacion nga pedagogu për format, kriteret dhe peshën e secilit komponent në vlerësimin përfundimtar. Ato përshkruhen gjithashtu në programin e studimeve dhe planin mësimor. Syllabuset e lëndëve dhe planet kalendarike janë të hapura për studentët në site-et personale të pedagogëve. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë. Tezat e provimit hartohen nga titullari i modulit dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Gjatë zhvillimit të provimit nuk lejohet ndërimi i tezës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive</p>	<p>Nga verifikimet u konstatua që vlerësimi i njohurive, aftësive dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>dijeve të studentit gjatë gjithë semestrit dhe studentët janë njohur për të në rregulloren e FEA. Ky vlerësim ndahet në dy pjesë: Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit i cili përfaqëson 30% - 50% të vlerësimit total (në lëndë apo module të ndryshme është i ndryshëm dhe përcaktohet nga titullari i lëndës në programin disiplinor të dorëzuar në fillim të vitit); Vlerësimi përfundimtar që përfaqëson sipas rastit 50% - 70% të vlerësimit total. Këto programe miratohen çdo vit nga përgjegjësi i departamentit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Për zbatimin e këtij kriteri, deri më tani korrigjimet bëhen nga pedagogët dhe janë transparente tek studentët pikët dhe vlerësimi. Nëse ka ndonjë ankesë, studentët drejtohen në njësinë bazë të cilët ndjekin procedurën e përcaktuar në rregullore. Me qëllim reduktimin e abuzimeve dhe subjektivizmit në vlerësimin e studentëve, mendohet (sipas një marrëveshjeje të nënshkruar me Fondin Shqiptar të Zhvillimit) të bëhet e mundur blerja dhe vënia në funksionim e një sistemi të brendshëm të korrigjimit elektronik. Mendohet të përdoret për testimet e ndërmjetme / detyrat e kontrollit apo provimet finale të ndërtuara në formë testi (me alternativa). Në rastet kur teza përmban edhe pyetje të natyrave të tjera (p.sh. ushtrime), ato do të korrigjohen nga pedagogu/ët përkatës.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në rregulloren e FEA shkruhet se komisionet e provimeve përbëhen nga jo më pak se dy anëtarë. Ato përcaktohen nga përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me Zv. Dekanin për mësimin dhe miratohen nga Dekani i FEAs. Bazuar në Rregulloren e FEAs, në rast se njëri nga pedagogët nuk mund të marrë pjesë në provim, përgjegjësi i departamentit përcakton personin që do ta zëvendësojë. Kur zëvendësimi është i pamundur, provimi shtyhet jashtë sezonit por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i tij. Diçka e tillë propozohet nga Dekani i fakultetit dhe miratohet nga Rektori. (Neni 69, Rregullore e FEAs, Ankes A.10). Nga konstatimi në vizitën në institucion u vu re që kjo zbatohet me përgjegjshmëri.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Gjatë testimit të njohurive të studentëve në lëndët përkatëse për ruajtjen e anonimatit të studentëve është përdorur një fletore tip e cila në faqen e parë të saj përmban elementët e nevojshëm të sigurisë. Ky tip sekretimi nuk përdoret në të gjitha lëndët dhe modulet dhe kjo paraqitet si një mangësi, por mendohej që brenda qershorit të</p>

	<p>këtij viti do të përdorej një metodë elektronike sekretimi. Ambjentet e FEAs në të cilat zhvillohet mësimi/provimi janë të monitoruara me një sistem qendror kamerash dhe personel shërbimi, detyra e të cilit është ruajtja e qetësisë dhe e sigurisë për zhvillimin normal të procesit mësimor dhe provimeve.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Titullarët dhe asistentët e lëndëve dhe moduleve të këtij programi studimi i japin informacion dhe i orientojnë studentët mbi të gjithë elementët e vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale. Nga takimi me studentët u informuam që ata që në fillim të lëndës orientohen nga pedagogët në lidhje me programin e lëndës dhe detyrimeve të saj, me testimet e ndërmjetme, me pikët që i korespondojnë atyre, me strukturën e detyrave e projekteve të kursit. Në vazhdim ata instruktohen me menyrën se si do të realizojnë këtë detyrë kursi apo projekt, i cili në fund të lëndës apo modulit prezantohet nga studentët para kursit të tyre dhe pedagogut të modulit (kjo bëhet në forma të ndryshme sipas rastit në ppt, foto, video në orët e fundit të seminareve). Një procedurë e tillë mundëson marrjen e feedback-ut si nga pedagogu ashtu dhe nga studentët e tjerë në lidhje me aspektet pozitive të punimit apo elementët që kanë nevojë për përmirësim apo detajim të mëtejshëm. Ky proces ballafaqimi me një audiencë të caktuar ndihmon studentët të përmirësohen në drejtim të mësimnxënies si dhe të fitojnë/ përmirësojnë aftësitë e tyre referuese (prezantuese).</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Personeli akademik eviton kopjimin në provime dhe për këtë nuk lejohet në asnjë rast që studenti të përdorë gjatë provimit celularë apo çdo mjet a formë tjetër të palejueshme. Në rast se verifikohet diçka e tillë, studenti përjashtohet nga provimi. Lidhur me plagjiaturën në detyra kursi apo tema diplome, nuk mund të evidentohet sepse në institucion nuk ka akoma një software specifik me qëllim kontrollin e temave të diplomave dhe detyrave të kursit. Mendohet që shumë shpejt të bëhet e mundur pajisja me këtë software. Por në ato raste kur pedagogët me mjetet e mënyrat e tyre e konstatojnë atë, studenti penalizohet në mos futjen në provim dhe diplomë. Studentët lejohen të futen në provim vetëm kur ata paraqesin një mjet identifikimi si librezë e studentit apo karta e identitetit. Gjatë provimit, ndalohet hyrja në salla e çdo personi të jashtëm qoftë dhe anëtar i personelit të universitetit përveç përgjegjësit të departamentit dhe personave të tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani, Rektori apo Rektorati për të bërë monitorim apo kontroll.</p>

	Me të gjitha këto detyrime studenti njihet që në fillim të studimeve nga përgjegjësi i programit dhe janë gjithashtu të shkruara dhe në rregulloren e masterit.
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	<p>Nga vizita në institucion, RVB dhe takimi me studentët dhe pedagogët rezultoi se vlerësimi i të gjitha formave të kontrollit të dijeve bëhet me pikë të cilat në përfundim konvertohen në notë. Për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit me nota nga 1 në 10 ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Notat nga 5 deri në 10 janë kaluese.</p> <p>Totali i pikëve të grumbulluara gjatë semestrit (në detyrat e kontrollit dhe detyrat e kursit) i bëhen me dije studentit në formë verbale nga ana e pedagogut në orën e fundit të seminarit. Këto rezultate hidhen më pas nga pedagogu në sistem. Hedhja në sistem e rezultateve të vlerësimit të vazhduar bëhet gjithsesi para datës së provimit përfundimtar. Rezultati përfundimtar hidhet në sistem nga komisioni i provimit brenda 2 ditëve kur provimi është me gojë dhe brenda 8 ditëve kur provimi përfundimtar është me shkrim. Këto parashikime janë të përfshira në Rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e FEA dhe studentët janë të mirëinformuar për të gjithë procesin.</p>
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	<p>Institucioni garanton të drejtat e studentëve (në lidhje me vlerësimin, etj), e parashikuar kjo në rregulloren e programit të studimit dhe rezultoi dhe nga takimi me studentët e këtij programi studimi gjatë vizitës në institucion. Studentët kanë të drejtë të njihen me vlerësimin e tyre për të gjitha modulet që ata zhvillojnë. Ata rezervojnë të drejtën për të kërkuar rishikim të vlerësimit në rast të paqartësive apo kundërshtimeve në lidhje me këtë të fundit brenda 48 orëve nga marrja e rezultatit. Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Pas këtij afati nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të proceverbalit në sistem brenda 2 ditëve. Në rastet e hedhjes së gabuar të notave/notës nga ana e komisionit, në lidhje me vlerësimin e studentit, komisioni ka detyrimin të verifikojë dhe bëjë korrektimin vetëm brenda kohës prej 12 ditësh. Mbase rezultati është hedhur dhe pranuar në sistem, dhe ka kaluar afati kohor i 12 ditëve (nga dita e provimit), sistemi mbyllet dhe komisioni nuk ka më të drejtë të bëjë ndryshim. Në raste të jashtëzakonshme mbas këtij afati kohor (12 ditëve), komisioni i paraqet një kërkesë me shkrim përgjegjësit të</p>

	<p>departamentit për ndryshimin e notës së pretenduar dhe me miratimin e dekanit të fakultetit korrigohet nota në sistem nga specialisti përgjegjës i IT të UBT i cili depoziton praktikën dokumentare tek ZSS. Procesverbali i korrigjuar arshivohet në ZSS. Mbas hedhjes përfundimtare në sistem të notave, komisioni printon pasqyrën përfundimtare të rezultateve të provimit, i plotëson me firmat e nevojshme (komisionit, përgjegjësit të departamentit/dekanit) dhe e dorëzon tek sekretarja e departamentit e cila më tej i dorëzon në ZSS (zyra e studimit dhe studentëve.</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Çdo kërkesë dhe ankimim i studentëve shqyrtohet bazuar në rregulloren e FEA dhe rregulloren e programit. Rregullorja e FEA-s, neni 79 dhe Rregullorja e programit të studimit, neni 39, përcaktojnë qartë procedurat e ankimit të studentëve dhe të trajtimit të ankesave. Në bazë të këtyre rregulloreve studenti ka të drejtë të ankimohet kur: a) ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit. Në këtë rast ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit; b) nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Ankesa me shkrim bëhet brenda 2 diëve (48 orë) nga marrja e rezultatit. Ankesat shqyrtohen nga dekani i cili mund të thërrasë për sqarime përgjegjës të departamentit, komisionin e provimit, si dhe vetë studentin. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Ky vendim është i formës së prerë. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos në bashkëpunim me përgjegjës të Departamentit, që studenti të rijapë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë, në një datë tjetër brenda sezonit, ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në dekanat. Kjo procedurë ndiqet për çdo rast ankimi nga ana e studentëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p> <p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p> <p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde</p> <p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit përmban 18 module ku studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të vendimmarrjes së biznesit. Kjo e fundit i referohet planifikimit dhe menaxhimit afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të bizneseve si edhe përdorimit të informacionit nga tregu në funksion të kësaj vendimmarrjeje. Modulet janë të ndara në mënyrë të balancuar të lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse. Kjo garanton thellimin e njohurive të studentëve dhe zhvillimin e aftësive profesionale të tyre.</p> <p>Në syllabuset e çdo lënde studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në modulën përkatës. Në përfundim të çdo moduli studentët fitojnë një grup kompetencash dhe aftësish të ndara në 3 grupe: a) kompetenca instrumentale, b) kompetenca sistemike, dhe c) kompetenca komunikuese.</p> <p>Në syllabuset e detajuara janë përcaktuar specifikisht kompetencat specifike sipas këtyre grupeve që fitojnë studentët në secilin modul të programit të studimit.</p> <p>Në fund të semestrit, pedagogët e moduleve realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synoheshin të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të modulit. Njëkohësisht, merret edhe feedback nga ana e studenteve lidhur me objektivat e vendosura për këtë qëllim. Gjithashtu, ata orientohen në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin final, strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë ky provim.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në FEA organizohen orë leksionesh të hapura nga personeli akademik dhe lektorë të ftuar për tema të veçanta dhe që janë me interes për studentët. Një numër i konsiderueshëm pedagogësh nga universitete partnere në kuadër të projekteve Erasmus+ kanë dhënë leksion me studentët e ciklit të dytë të studimeve.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p> <p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në</p>	<p>Pas dhënies së informacionit teorik për grup kompetencash, studentët testohen t'i aplikojnë këto kompetenca në praktikë, laboratorë kompjuterikë për module të caktuara të kurrikulës (siç është rasti i modulit "Sistemet e informacionit të drejtimit"). Studentët inkurajohen dhe vihen të vihen të punojnë në grupe prej</p>

<p>grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p> <p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>tre apo katër studentësh, punë e cila materializohet në një detyrë / projekt kursi, rast studimi apo stimulim i zgjidhjes së një problemi biznesi. Por, konstatohet që ata duhet të kenë mundësi të aplikojnë në praktikë edhe kompetenca të fituara në lëndë të tjera ose të studiojnë raste konkrete të ndërmarrjeve bujqësore në vend. Edhe nga biseda me studentët, nevojitet më shumë konkretizim i teorisë në praktikë dhe kjo vlen për të gjitha modulet e programit.</p>			
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Studentët e vitit të fundit Master marrin pjesë në kërkim nëpërmjet diplomave ose mikrotezave që realizojnë. Kërkimet më të vlerësuara prezantohen në konferenca të organizuara nga Universiteti /Fakultetet dhe në konferenca të posaçme që ata vetë organizojnë, nëpërmjet shoqatave studentore. Shoqata e studentëve të FEA për gjashtë vitet e fundit ka organizuar 6 konferenca studentore.</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Mobilitetet e studentëve në Universitetet e huaja partnere në kuadër të Programit Erasmus+ KA1 janë shtuar vitet e fundit për shkak të ndërthurjes së formave të mësimdhënies së pedagogëve dhe përputhjes dhe njohjes së moduleve respektive si dhe e ngjashmërisë dhe përshtatjes së kurrikulave me Universitetet partnere. Kjo ndikon në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mobiliteteve të studentëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfutimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p> <p>Kriteri 3. Praktikant profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Praktika profesionale është pjesë e kurrikulës së programit të studimit Master Profesional. Ato zhvillohen në semestrin e II të vitit të dytë të studimeve dhe ka 20 kredite.</p> <p>Mënyra e organizimit të praktikave profesionale për studentët e Masterit Profesional është e percaktuar në nenin 40, të Rregullores së DDA-së, Departamenti evidenton kompanitë / institucionet e mundshme ku studenti mund të kryejë praktikën profesionale.</p> <p>Studentët mund gjithashtu të propozojnë vetë vendin e kryerjes së praktikës. Departamenti bën ndarjen e studentëve nëpër kompani / institucione pritëse sipas profilit të përgatitjes së studentit duke respektuar njëkohësisht dhe dëshirën e këtij të fundit.</p> <p>Dekani i fakultetit nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi me të gjitha institucionet pritëse deri 1 muaj para fillimit të praktikës. Mbrojtja e praktikës profesionale bëhet në datat dhe oraret e percaktuara. Në ditën e mbrojtjes së praktikës studenti i paraqet komisionit të ngritur për këtë qëllim “dosjen” e praktikës ku përfshihen: Relacioni për punën e kryer; Marrëveshja e nënshkruar; Vlerësimi për studentin përgatitur nga kompania / institucioni ku studenti ka kryer praktikën.</p> <p>Komisioni i ngritur nga departamenti për vlerësimin e praktikës profesionale merr në konsideratë gjithë sa më sipër për vlerësimin e studentit. Vlerësimi i praktikës profesionale në procesverbal bëhet me Fiton/Nuk Fiton. Nëse studenti nuk paraqitet në datën e caktuar, në procesverbal shënohet “Nuk u paraqit”. Nëse studenti në praktikën profesionale vlerësohet me “Nuk fiton” shpallet përsëritës dhe duhet ta shlyejë atë në vitin akademik pasardhës. Nëse studenti në praktikën profesionale vlerësohet me “Nuk u paraqit” duhet ta shlyejë atë në sezonin e vjeshtës të vitit të tretë ose në datat e provimeve të shpallura para sezonit të diplomimit.</p> <p>Nga takimi me studentët u kuptua se shumicën e rasteve ata duhet ta gjenin vetë vendin pritës ku do të realizonin praktikën. Në disa raste të tjera ata nuk mikpriteshin, ose mikpriteshin vetëm për një periudhë të shkurtër kohe. Sipas tyre, institucionet pritëse nuk angazhoheshin për tu mësuar atyre si funksiononin ndërmarrjet dhe për të parë në praktikë zbatimin e teorisë që kanë mësuar. Në këtë këndvështrim mendojmë se institucioni duhet të angazhohet pak më shumë për të përmirësuar funksionimin e praktikave profesionale.</p>			
Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet

standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

Standardi III.9

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p> <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p> <p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Struktura e planit të diplomimit është ndërtuar në mënyrë të tillë që diplomimi të realizohet brenda afateve të parashikuara prej 2 vite akademike. Mënyra e diplomimit paraqitet e detajuar në udhëzimin për punimin e diplomës dhe kalendarin e diplomës, të cilët u njoftohen pedagogëve dhe studentëve në një afat të arsyeshëm kohor me qëllim marrjen e masave për përgatitjen e saj. Institucioni ka një procedurë të posaçme për provimin final, e specifikuar në rregullore dhe e publikuar në faqen Web.</p> <p>Të gjithë studentët me notë mesatare 6.5 e lart mund të paraqesin një punim diplome. Studentët e kësaj kategorie dhe të interesuar për të paraqitur një punim diplome në përfundim të programit të studimit, paraqesin kërkesën e tyre me shkrim në lidhje me punimin dhe udhëheqesin e tij pranë departamentit duke plotësuar një formular aplikimi.</p> <p>Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat e studentëve, harton listën përfundimtare të të gjithë atyre që i plotësojnë kriteret për të paraqitur një punim diplome dhe njëkohësisht miraton dhe udhëheqësin. Informacioni në lidhje me afatet e dorëzimit të aplikimeve, listën e studentëve që fitojnë të drejtën për t'u paraqitur në provimin përfundimtar të formimit/punim diplome e më pas lista e studentëve që janë miratuar për të paraqitur një punim diplome, bëhet publike në stendat informative brenda ambienteve të FEA-s. Kriteret dhe standardet e përgatitjes së një punimi diplome dhe programi i provimit përfundimtar të formimit përcaktohen nga departamenti dhe bëhen publike në site-in e departamentit të DDA-së.</p> <p>Të gjitha informacionet në lidhje me provimin final dhe mbrojtjen e temës bëhen publike në një stendë informuese të departamentit dhe në faqen Web.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe informacionet e marra edhe nga RVB, komisioni i provimit përbëhet nga anëtarë të departamentit të fushave që mbulon programi i studimit. Përpara datës së provimit studentët kanë marrë fondin e pyetjeve sipas fushave të studimit dhe tezat e provimit hartohen nga Komisioni bazuar në këtë fond.</p>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit</p> <p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit</p> <p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>FEA ka një procedurë të përcaktuar dhe të mirëzbatueshme në lidhje me orientimin dhe ndihmën ndaj studentëve në lidhje me punimet e diplomave. Kjo nis që me shpalljen e emrave të pedagogëve pjesë e programit të studimit dhe fushat e tyre të kërkimit. Nga ana tjetër plotësimi i kërkesës për punim diplome kërkon që studentin në dakordësi dhe me orientimin e pedagogut të përcaktojnë fushën specifike ku do të fokusohet punimi i diplomës; kjo çon dhe në minimizimin e plagjiaturës.</p> <p>Studentët mund të përdorin të gjitha mundësitë dhe pajisjet që ofron shkolla për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tij shkencor, si p.sh bibliotekën, laboratorët, etj.</p> <p>Udhëheqësi angazhohet në përcaktimin e programit të punës së studentit dhe afatet për realizimin e këtij të fundit. Konsultimet udhëheqës – student janë të vazhdueshme deri në momentin kur punimi i diplomës konsiderohet i përfunduar. Gjatë këtyre konsultimeve kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar si dhe asistohen studentët në kryerjen e analizave apo modeleve të ndryshme në mënyrë që punimi të paraqitet sipas kriterëve dhe standardeve të përcaktuara.</p> <p>Në fund, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studentin dhe lejon mbrojtjen e tij duke e firmosur.</p> <p>Në përfundim të studimeve, studentin dorëzon kopjen e punimit të diplomës të miratuar nga udhëheqësi shkencor. Mbrojtja e diplomës dhe provimi final bëhet përpara një komisioni me 5 anëtarë të propozuar nga departamenti dhe të miratuar nga dekanati. Mbrojtja bëhet me gojë dhe vlerësimi final i studentëve është me notë. Rezultatet e provimit final / mbrojtjen e diplomës u bëhen me dije studentëve në fund të çdo dite provimi. Këto procedura janë të zbatueshme dhe të njohura nga studentët e pedagogët.</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentin pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në zbatim të ligjit të Arsimit të Lartë, në përfundim të studimeve në Master Profesional, studentin pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës.</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Nga takimi me studentët u informuam që atyre u vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, në rast se ata e kërkojnë këtë gjë.</p>
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.</p>	<p>I gjithë dokumentacioni për studentët ruhet nga IAL për një periudhë të pacaktuar në hard copy (regjistrat themeltar të studentëve) si dhe në databazën digjitale ESSE3 që disponon UBT.</p> <p>Në UBT funksionon Zyra e Studimeve dhe Studentëve e cila</p>

	<p>është pjesë e organigramës së Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional (DZHKKVI). Mbështetur në legjislacionin në fuqi, dokumentacioni themelor për studentët është: Regjistri themeltar i studentit, i cili vërteton regjistrimin e studentit që pajiset me numër matkulimi deri në marrjen e diplomës ose certificates; Regjistri i arritjeve akademike të studentit që vërteton rezultatet e studentit gjatë aktivitetit të tij akademik; Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave që vërteton emërtimin e certifikatave dhe diplomave. Dokumentacioni në hard copy ruhet në ambjentet e ZSS-së së universitetit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>Në fillim të çdo viti akademik, DDA analizon nevojat dhe kërkesat për personelin akademik të programit të studimit duke përpiluar një dokument ku planifikohet ngarkesa mësimore e vitit në fjalë. Në përfundim të këtij procesi, departamenti parashikon se cilat janë nevojat për personel të ftuar, të cilët do të përmbushin detyrat dhe përfitojnë të drejta kundrejt një kontrate. Për menaxhimin e marrdhënies së punës me këta individë, UBT ka miratuar edhe rregulloret përkatëse në lidhje me menaxhimin dhe rekrutimin e personelit (Rregullore e drejtorisë së Menaxhimit të MBNJ / Rregullore e rekrutimit UBT). Bazuar në nevojat e përcaktuara nga DDD, procesi i rekrutimit të stafit të ftuar koordinohet me Drejtorinë e Menaxhimit të Personelit dhe Pagave (Rregullore e rekrutimit UBT). Në këtë drejtori ka dosje me të dhëna të plota për anëtarët e personelit akademik që</p>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

41

<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>mbulon programin e studimit. Nga dosjet e personelit akademik të shqyrtuara gjatë vizitës në Institucion rezulton se të dhënat në lidhje me titujt e fituar në kohë dhe karrierën përditësohen duke plotësuar informacionin. Zyra e Burimeve Njerëzore disponon informacione të qarta në këtë drejtim (Rregullore e Drejtorisë së MBNJ dhe pagave). Gjithashtu në Rregulloren e Drejtorisë së MBNJ dhe pagave thuhet se këto evidenca janë të vlefshme si për institucionet brenda vendit (si INSTAT) edhe për ato jashtë vendit. Informacioni i gjeneruar ruhet në arkivën e UBT-së (Rregullore e Drejtorisë së MBNJ dhe pagave).</p> <p>Drejtoria e menaxhimit të Personelit dhe Pagave ndjek procedurat e posaçme për rekrutimet e personelit akademik në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e Rregullores së kësaj drejtorie. Kjo drejtori është përgjegjëse, në bashkëpunim me departamentin, për plotësimin e nevojave të programit të studimit për staf akademik si dhe për procesin e përzgjedhjes së stafit akademik të ftuar. Edhe nga vizita e realizuar në zyrën e BNJ dolën në pah detyrat që kryen në lidhje me këtë proces. Kjo procedure konsiston në: koordinimin e punës me njësinë bazë për programin e studimit, ku njësia bazë paraqet kërkesën për personel të ftuar bazuar në nevojat e evidentuara në fillim të vitit akademik si dhe kriteret e veçanta; më pas hartohet oferta e punës duke përfshirë këtu kriteret e pranimit të përgjithshme dhe të veçanta; më tej vazhdohet me shpalljen e njoftimit për vend pune vakant në web si dhe në buletin e APP-së, për një afat kohor 20 ditë; më pas krijohen komisionet për vlerësimin e dosjeve, zhvillohet konkursi dhe pas tij jepet informacioni përfundimtar dhe shpalljet e vendimi (Rregullore e Drejtorisë së MBNJ dhe pagave- Neni 6).</p> <p>Drejtoria e Menaxhimit të Personelit dhe Pagave, në bashkëpunim me DDA realizon procedura të qarta për mbarëvajtjen e procesit të rekrutimit të personelit akademik. UBT, mbështetur në rregulloren e rekrutimit, përcakton të gjitha hapat e procedurës që parashikon rregullorja (Rregullore e rekrutimit UBT, Neni 3 & Neni 4), të cilat respektohen në mënyre rigorozë; si dhe kriteret e përgjithshme dhe specifike për rekrutimin e personelit (Rregullore e rekrutimit UBT) të cilat, bëhen publike në APP dhe në faqen zyrtare të UBT. Në anekset e rregullores janë ta përcaktuara qartësisht formatet e pikëzimit të kriterëve (Rregullore e rekrutimit UBT, fq.8-9 “Kriteret e rekrutimit” / Praktikë punësimi staf akademik).</p> <p>DDA në bashkëpunim me Drejtorinë e Personelit dhe Pagave</p>
---	---

	<p>respekton në mënyrë rigorozë nenet e rregulloreve në lidhje me menaxhimin dhe rekrutimin e stafit të saj. Rregullorja e rekrutimit përcakton qartësisht kriteret për përzgjedhjen e stafit akademik sipas titujve akademikë. Në anekset e këtyre rregulloreve specifikohen kriteret e përgjithshme në lidhje me notën mesatare të dy cikleve të studimit dhe profilin e studimeve dhe pasqyrohen gjithashtu kriteret specifike që lidhen me studime të mëtejshme, përvoja e punës në mësimdhënie, tituj akademik të fituar brenda apo jashtë vendit, njohuri të gjuhëve të huaja, aktiviteti botues shkencor, etj. (Rregullore e rekrutimit UBT, fq.8-9 “Kriteret e rekrutimit” / Praktikë punësimi staf akademik).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit. Kjo si në aspektin e kushteve por edhe të mundësive për të marrë informacionin e nevojshëm. DDA e ka prioritet sigurimin e mjediseve për realizimin e detyrave dhe dhënien e mundësive të barabarta personelit akademik të saj. Çdo anëtar i personelit akademik ka një zyrë të pozicionuar në një nga dy godinat e FEA, ku mund të punojë më mënyrë të pavarur. Zyrat janë të pajisura me mjete dhe pajisje të nevojshme (si kompjuter, fotokopje videoprojektor etj.) për zhvillimin e detyrave përkatëse të personelit akademik. Rikonstruksioni i mjediseve të DDA ka krijuar mundësinë e përfshirjes në mënyrë funksionale të zyrës së sekretarisë së departamentit me qëllim realizimin më të mirë të kontaktit me stafin, studentët dhe pjesën tjetër të stafit ndihmës. Departamenti angazhohet plotësisht për të përmirësuar mjediset e zhvillimit të mësimin, të cilat rezultojnë të mjaftueshme, të ndriçuara, duke siguruar kushte të mira për zhvillimin e mësimin. Sistemi ëireless në mjediset e FEA krijon kushte të mira për të përmirësuar edhe teknikat e mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet</p>	<p>Në strategjinë e UBT ndër të tjera, prioritet është edhe kërkimi</p>

<p>për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>shkencor. Kërkimi shihet si pjesë integrale e rolit akademik dhe një faktor kyç në promovim. Institucioni e ka vendosur theksin në identifikimin e fushave të qëndrueshme të kërkimit si dhe në bashkërendimin e përfshirjen e elementëve të planifikimit të veprimtarisë shkencore në nivel departamenti (Plani Strategjik i UBT).</p> <p>Institucioni, gjithashtu dhe DDA, mbështet aktivitetin kërkimor dhe shkencor ku nëpërmjet të cilit nxit personelin akademik për zhvillim profesional të vazhdueshëm (Statuti i UBT, Neni 59). Tematika e kërkimit në UBT zhvillohet në përputhje me prioritetet e kërkimit dhe programet e ofruara (Statuti i UBT, Neni 59). Organizimi i grupeve mësimore dhe kërkimore në DDA përpqej të parashikonte një ndarje më të orientuar të punës kërkimore e shkencore në drejtim të fushave dhe projekteve prioritare. Detyrat dhe funksionet e këtyre grupeve kërkimore në drejtim të kërkimit shkencor janë të përcaktuara qartë dhe përfshijnë përmbushjen hartimin dhe implementimin e planeve vjetore të kërkimit shkencor, organizimin e bashkëpunimeve me grupe të tjera kërkimore e shkencore brenda ose jashtë Institucionit apo vendit, bashkëpunimeve me sipërmarrjet private, publikimin e rezultateve të punës kërkimore shkencore dhe nxitja e botimeve shkencore brenda dhe jashtë vendit, etj. (Rregullore e DDA- Neni 7, Pika B). Personeli akademik i DDA ka treguar arritje të kënaqshme në fushën e kërkimit. Ky fakt mbështetet në numrin e kënaqshëm të artikujve shkencorë të botuar në revista të huaja të njohura si edhe pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare organizuar brenda dhe jashtë vendit (Publish&Perish_Staf akademik DDA 2018; Raporti i Analizës së Punës Kërkimore UBT 2017 & Analiza e punes shkencore DDA 2018). Kualifikimi i personelit akademik në fushën e kërkimit ndihmon në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies (Plani Strategjik i UBT).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Nisur nga kualifikimi dhe përvoja pedagogjike mund të thuhet se personeli akademik i programit të studimit ka mjaftueshëm cilësi për realizimin e një procesi mësimor cilësor dhe me teknika inovative. Institucioni krijon mbështetje me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e mësimit dhe vendosjen në dispozicion të materialeve udhëzuese në përdorimin e metodave inovative, të cilat kanë përmirësuar ndjeshëm komunikimin e shpejtë dhe efektiv me studentët. Metodatat inovative që përdoren dhe zhvillohen për rritjen dhe përmirësimin e procesit të mësimdhënies janë të parashikuara në Udhëzuesin për zhvillimin e metodave inovative, si vijon: <i>E-Learning</i> është një mënyrë</p>

	<p>elektronike e të mësuarit, që nënkupton dhënien e njohurive, mësimdhënies ose studimit, duke shfrytëzuar teknologjinë elektronike si kompjuter, pajisje mobile etj; <i>Google site</i> është një aplikacion online që ndihmon në krijimin e një projekti në ëeb ose të një faqe web-i. Pedagogët në UBT kanë krijuar me anë të këtij aplikacioni ëeb-sitet e tyre personale ku studentët mund të aksesojnë materialet e lëndëve që zhvillohen nga këta pedagogë. https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/site_menager/home; <i>MOODLE</i> (Virtual Learning Environment), është një aplikacion LMS (Learning Management System) i cili mundëson menaxhimin e materialit mësimor dhe administrimin e procesit mësimor, nëpërmjet krijimit të faqeve ëeb dinamike për studentët nga ana e pedagogëve; <i>TEEAL</i> (The Essential Electronic Agricultural Library) është një bibliotekë online ku stafi akademik i UBT mund të aksesojë publikime të ndryshme; <i>Moduli online "Njohuri për informacionin"</i> është një pakete e përkthyer me libra online të Universitetit të Cranfield (Mbretëria e Bashkuar), e cila orienton studentin se si të gjejë informacionin e duhur për të shkruar një detyrë apo punë shkencore. Ky modul është rezultat i Projektit TEMPUS; <i>Sistemi ESSE3</i> është një sistem i integruar për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve nga aplikimi në Universitet, jeta unversitare deri në mbrojtjen e diplomës. Personeli akademik i departamentit të Drejtimit të Agrobiznesit ka qenë pjesë e mjaft mobiliteteve Erasmus+ me karakter trajnues për aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies. Në objektivat dhe rezultatet e këtyre mobiliteteve janë qartësisht të motivuara qëllimet e vizitave dhe pritshmëritë e tyre. Në kuadër të këtyre projekteve të bashkëpunimit, personeli akademik i DDA ka qenë pjesë e disa trajnime të rëndësishme në këtë kontekst, përmendim këtu: "Grant Writing" dhe "Prioritization Settings" (organizuar nga projekti AHEED), trajnimi i realizuar nga projekti DOCSMEC në lidhje me e-learning si dhe trajnimi për përdorimin e metodës "Conjoint Choice Analyses" (projekti AHEED - UBT me Universitetin e Hawaii) si një metodologjie kërkimi. Si rezultat i përdorimit të metodologjisë së kërkimit janë realizuar shumë artikuj shkencor dhe punime doktorature. (Lista e projekteve të UBT 2017-2018 / Analiza e punes shkencore DDA 2018).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit kujdeset që të respektojë planet, objektivat dhe rezultatet e paracaktuara të programit të studimit. Planet mësimore, syllabusi, orari i mësimit dhe dokumenta të tjera që personeli akademik depoziton në departament dëshmojnë për korrektësi dhe respektim të këtyre</p>

	elementeve nga personeli akademik duke krijuar në këtë mënyrë një vazhdimësi komunikimi me studentët. Ky fakt mbështetet dhe dëshmohet nga pyetësorët që studentët plotësojnë përpara sezonit të provimeve (2 herë në vit), në vlerësimin e performancës së personelit akademik, rezultatet e të cilit janë pjesë e analizën vjetore të njësisë kryesore dhe asaj bazë. Nga ana tjetër, vihet re angazhimi i personelit akademik të programit në përmirësimin e vazhdueshëm të materialet mësimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Procesi mësimor për programin e studimit zhvillohet në dy godina kryesore, Godina A dhe Godina B. Godina A është e organizuar në 2 kate dhe ka në përbërje të saj 7 salla leksionesh dhe 14 salla seminaresh, si dhe 4 laboratorë (të pajisura me 25 kompjutera secila sallë) për zhvillimin e lëndëve të ndryshme të programit. Ndërsa godina B është e organizuar në 4 kate dhe ka në përbërje të saj 8 salla leksionesh dhe 23 salla seminaresh, si dhe 2 laboratorë (krijuar dhe vendosur në funksionim në shtator 2017) për zhvillimin e lëndëve të ndryshme të programit. Në kompjuterat e këtyre laboratorëve janë instaluar të gjitha programet (software) e nevojshme për realizimin me sukses të punës së pavarur nga studenti. Këto salla janë produkt i projekteve të ndryshme ndërkombëtare, të koordinuara nga anëtarët e stafit të FEA-s dhe investim i universitetit (dy sallat me fonde të Universitetit). Ambientet ku zhvillohet mësimi i këtij programi studimi plotësojnë kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme në përputhje me normativën e përcaktuar në VKM. Nr. 418, datë 10.05.2017, sipas të cilit kërkohen 2.5 m ² për një student. Mjediset e FEA janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor. Mjediset mësimore, në varësi të funksionit të tyre janë të pajisura me të gjitha mjetet e përshtatshme për zhvillimin e mësimdhënies, përfshirë kompjutera, video-projektorë, lidhje
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	

<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>interneti, që nevojitet për zbatimin e procesit mësimor, etj. Në klasat e seminareve mund të përdoren mjetet audiovizuale që janë të depozituara në department dhe mund të ofrohen nga sekretaria e departamentit për të realizuar prezantime, detyra apo projekte kursi. Disa nga klasat janë të pajisura edhe me Smartboard me sistemin elektrik dhe ëireless e cila mundëson zhvillimin e mësimin në kushte shumë të mira. Zyrat e personelit akademik janë të pajisura me paisjet e nevojshme dhe internet për të mundësuar përmbushjen e detyrave të personelit. Për realizimin e praktikës profesionale, Institucioni ka marrëveshje me Institucione Publike dhe Private për angazhimin e studentëve. Rol të rëndësishëm luan gjithashtu edhe Zyra e Karrierës me përpjekjet e vazhdueshme në këtë drejtim dhe me organizimin e aktiviteteve specifike si psh. Panairi i Karrierës në Maj 2019, etj.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në UBT gjenden dy biblioteka: Biblioteka qendrore “Mentor Përmeti” dhe Biblioteka e Fakultetit Ekonomik, e cila është e vendosur në mjediset e godinës B. Bibliotekat kanë mjaftueshëm hapësirë për studentët për të studiuar apo për të përdorur literaturën fizike të tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Bibliotekat janë të pajisura me literaturë fizike të mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaj. Literatura fizike më e gjerë është në fushën e Menaxhimit dhe të Marketingut, në gjuhën shqipe dhe angleze, me të cilat lidhet shumica e lëndëve të programit të studimit. Studentët kanë akses të plotë në shfrytëzimin e kapaciteteve të bibliotekës, pa pagesë, duke patur mundësinë të shfrytëzojnë edhe platforma online. Informacioni online ofrohet nga burime elektronike me abonim ose falas, nga projekte të ndryshme si Research4life me 5 programe: Hinari, Agora, Oare, Ardi, Goali. Biblioteka e UBT-së, pjesë e së cilës është edhe biblioteka e FEA-s, disponon platformën Springshare, që</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së</p>	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

47

programit të studimit.	mundëson rritjen e interaktivitetit të shërbimeve të bibliotekës me studentët. Gjithashtu, studentët, mund të shfrytëzojnë edhe informacionin nga katalogu online i bibliotekës. Të gjithë Informacionin në lidhje me shërbimet që ofron biblioteka studentët e aksesojnë edhe online në faqen përkatëse.			
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka e UBT ka zhvilluar strategjinë e saj dhe Politikën e Pasurimit të fondit të Bibliotekës. Studentët në të gjejnë tekstet mësimore të përcaktuara në syllabuse-t e lëndëve që ndjekin dhe literaturën ndihmëse të nevojshme, përzgjedhur mbi bazën e planit të hartuar nga përgjegjësi i programit. Në bibliotekë gjenden 500 tituj në gjuhën shqipe, 2.200 tituj në gjuhë të huaj si dhe 1.700 materiale-periodikë. Fondi i bibliotekës pasurohet në mënyrë të vazhdueshme duke synuar të reflektojë ndryshimet cilësore të programit të studimit si edhe azhornimin me zhvillimet më të fundit të literaturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në përditësimin e fondit merren në konsideratë vazhdimisht edhe sugjerimet e studentëve në mënyrë që të sigurohet literaturë sa më e përshtatshme. Institucioni zotëron edhe librarinë elektronike TEEAL, me akses në disa prej revistave më të mira. Përditësimi i kësaj biblioteke në vazhdimësi bëhet nga IAL. Gjatë vizitës në Institucion nuk ishte i mundur aksesimi i saj.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Biblioteka ofron hapësira të mjaftueshme për përdorim nga studentët. Salla e studimit ka kapacitet 50 vende dhe është e pajisur me kompjutera nga ku studentët mund të aksesojnë librarinë elektronike dhe të kryejnë punë kërkimore individualisht apo në grup. Kapaciteti i stafit të bibliotekës është i tillë që përballon nevojat e studentëve për shërbim, apo edhe shfrytëzim të mjediseve për punë në grup apo prezantime.			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Orari i shfrytëzimit të bibliotekës është i përshtatshëm për studentët në përputhje me orarin e tyre të mësimin, i cili është i mjaftueshëm për plotësimin e nevojave të studentëve të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik,

financiar e administrativ për programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni disponon një një sistem të brendshëm menaxhimi të brendshëm në të cilin regjistrohet dhe arkivohet i gjithë informacioni në lidhje me studentët nga momenti i regjistrimit deri në çertifikimin përfundimtar, pajisja me diplomën sipas ciklit përkatës. Ky sistem është konceptuar të funksionojë në dy drejtime: Informacioni i regjistruar dhe ruajtur në mënyrë elektronike; Informacioni i regjistruar dhe ruajtur në mënyrë fizike. Zyra që kujdeset për menaxhimin e këtij procesi është Zyra e Studimeve dhe Studentëve (ZSS) dhe kryen veprimtarinë në vijim: Regjistrimi i studentëve dhe mbajtja e bazës së të dhënave dhe rezultatet e tyre, në formë shkresore dhe elektronike; Plotësimi i të gjithë dokumenteve individuale çertifikues mbi rezultatet e pjeshme ose të plota të studimeve; Mbajtja e dokumentacionit mbi procesin mësimor dhe ndjekja e ecurisë së procesit mësimor; Mban informacion lidhur me studimet (planet mësimore, strukturat e vitit akademik etj.) për të gjitha drejtimet e diplomimit në të tre ciklet e studimeve me kohë të plotë dhe me kohë të pjeshme në Universitet (Rregullore e ZSS - Kreu VI.I.1). Kjo zyrë menaxhon edhe dokumentacionin themelor për studentët në përputhje me ligjin në fuqi, i cili përfshin: Regjistri themeltar i studentit i cili vërteton regjistrimin e studentit që pajiset me numër unik matrikulimi deri në marrjen e diplomës ose certifikatës, i cili pasqyrohet në këtë regjistër; Regjistri i arritjeve akademike të studentit që vërteton rezultatet e arritura të tij gjatë aktivitetit akademik sipas programeve të studimit; Regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave që vërteton emetimin e çertifikatave dhe diplomave. Këto regjistra ruhen, pas diplomimit, në arkivën e Shtetit Shqiptar, ndërsa në arkivën e UBT-së, si kopje e njësuar me origjinalin në hardcopy dhe elektronike, ruhen për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së Institucioni.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Departamenti i DDA, FEA, UBT, Zyra e Personelit dhe Zyra e Financës, në përputhje me Statutin e UBT dhe Rregulloren e DDA, ruajnë informacionet për aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Ky informacion ruhet në formë elektronike dhe hard copy. Dokumentacioni, i cili bëhet pjesë edhe e analizës mësimore shkencore, përbëhet nga CV, planet mësimore, syllabuset, kontributi institucional etj. Informacionet mbi analizat mësimore shkencore përcillen më pas në Dekanat dhe Rektorat. Në zyrën e personelit dhe pagave, në zyrën e financës, në Departament dhe në Fakultet ruhet edhe dokumentacioni për pedagogët e ftuar të programit. Kur ka ndryshime të titujve dhe gradave, informacioni në

	<p>Zyrën e Burimeve Njerëzore përditësohet. Në zyrat e Financës dhe të Buxhetit ruhet edhe informacioni mbi kategoritë e punonjësve, shpërblimet dhe honoraret e tyre etj. dhe ky informacion u vendoset në dispozicion edhe punonjësve sipas kërkesës. Gjithashtu në site-t personale të pedagogëve ruhen informacione mbi aktivitetin e tyre, lëndët dhe informacione të tjera të rëndësishme për publikun.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit krijon akses për personelin dhe studentët përmes formave të ndryshme. Raportet e analizës mësimore dhe shkencore në nivel departamenti, diskutohen dhe miratohen në mbledhje departamenti duke krijuar mundësinë që çdo anëtar i programit të studimit të ketë mundësi të marrë informacion. Informacioni në lidhje me aktivitetin e personelit të programit bëhet publik në ëbsitet personale të personelit, web, stenda siguron informacion për publikun. Shpërndarja e informacionit që lidhet me mbarëvajtjen e procesit mësimor dokumentohet në stenda dhe ëeb-in e Universitetit me seksion të veçantë për fakultetin, departamentin apo edhe programin e studimit. Ky informacion lidhet me strukturën e vitit akademik, orarin mësimor, kurrikulën e programit, prioritetet e kërkimit dhe fushat e ekspertizës, mundësitë e punësimit, kompetencat e stafit dhe studentëve etj. Informacion me karakter didaktik gjendet edhe në portalin e UBT-së në ëbsitet e pedagogëve për të mundësuar marrjen e informacion nga të interesuarit në distancë.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit ka integruar sistemin ESSE3 për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve nga aplikimi në Universitet, jeta universitare deri në mbrojtjen e diplomës. Studenti mund të monitorojë studimet e tij përmes një kodi unik identifikimi, që e shoqëron atë në gjithë eksperiencën e tij në Universitet. Përmes këtij sistemi studenti merr në kohë reale informacion në lidhje me të dhënat e regjistrimeve, lëndët, për të drejtën për të hyrë ose jo në provim, prenotimin e provimit, grafikun e provimeve online, vlerësimin e bërë nga pedagogu gjatë semestrit, vlerësimin në provim dhe notën përfundimtare notat, etj. Në lidhje me hapjen e grafikut për provime në këtë sistem, për sezonet e rregullta ky proces bëhet automatikisht nga sekretaret përkatëse të programit të studimit. Në sezonet e vjeshtës ku proces bëhet nëpërmjet prenotimit nga vet studentit në këtë sistem. Personeli akademik i departamentit shfrytëzon hapësirën personale në portalin e UBT-së për të komunikuar në mënyrë sa më efikente me studentët në lidhje me procesin mësimor-kërkimor. Secili anëtar i personelit akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi komunikon me studentët e kursit në lidhje me informacione për</p>

	leksionet e moduleve përkatëse, rastet studimore, detyrat e kursit si dhe e materialeve të tjera. Në këtë hapësirë të përbashkët studentët kanë akses në leksionet e modulit, syllabusin e tij, strukturën e modulit si edhe mënyrën e administrimit të tij përgjatë semestrit. Ata gjithashtu marrin në këtë hapësirë edhe informacion në lidhje me vlerësimin gjatë vitit. Website i UBT-së, me seksione të veçanta për DDA, siguron informacion të rëndësishëm për karakteristikat e programit.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Mbledhja e të dhënave dhe monitorimi në kohë reale i aktivitetit akademik dhe administrativ realizohet nga grupe pune të përbëra nga drejtuesi i departamentit, drejtuesit e grupeve mësimore dhe sekretarja e departamentit. Monitorimi bëhet duke parë respektimin e orarit mësimor, ngarkesës mësimore, etikës në komunikim etj. Më pas hartohen raporte që i drejtohen organeve drejtuese për marrjen e masave për përmirësimin e procesit aty ku është e nevojshme.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Informacioni në lidhje me programin e studimit në faqen e web-it gjendet në gjuhën shqipe. Faqja në gjuhën angleze është në ndërtim për t'u përputhur me dizejnimin e ri të faqes së universitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p> <p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>UBT harton një buxhet ku planifikohen midis të tjerash kuotat dhe kostot e programeve të studimit, përfshirë dhe njësinë kryesore që ofron programin në fjalë. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në UBT harton një raport financiar ku paraqiten kostot për student për ciklet e studimit Bachelor, Master profesional dhe Master i Shkencave. Plani financiar detajon kostot për të gjithë zërat në shërbim të realizimit të programit që nga shërbimet operative, kostot e burimeve njerëzore, shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve, shpenzimet për bibliotekën etj.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p> <p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Institucioni auditohet çdo vit, nga auditi i brendshëm i tij. Burimet e financimit janë: nga buxheti i shtetit, nga tarifat e studentëve dhe financim nga shërbimet që UBT ofron për aktorë të tretë. UBT bën publike pasqyrën e të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe burimet e tjera, për të pasur transparencë ndaj publikut në këtë drejtim. Gjithashtu hartohet raporti i analizës financiare për tre vitet e kaluara. Duke parë analizën e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të konstatuar se si janë realizuar dhe për të rritur eficientësinë në të ardhmen. Kjo shërben si një element për garantimin e qëndrueshmërisë financiare të nevojshme për mbështetjen e programit të studimit. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit hartojnë edhe relacionin mbi buxhetin afatmesëm dhe afatgjatë duke analizuar të gjitha programet e studimit të të gjitha cikleve. Në këtë mënyrë evidentohen problemet përkatëse dhe nevojat për investimet si dhe burimet e nevojshme të të ardhurave për të financuar këto investime për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

standardit				X
-------------------	--	--	--	----------

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në rregulloren e DDA ka politika dhe procedura në përputhje me legjislacionin në fuqi, që mbulojnë këto aspekte. Programi i studimit ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve duke zhvilluar njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale dhe analitike (Rregullores e Brendshme e DDA-s- - Rregullore e programit të studimeve) të nevojshme për zgjidhjen e problematikave komplekse në këtë fushë. Kriteret e pranimit të studentëve përcaktohen nga MASR (udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Ministrave apo MASR për vitin akademik përkatës), statuti dhe rregullorja e studimeve të DDA, FEA-s dhe UBT-së (Rregullore e Brendshme e DDA-; Rregullore e programit të studimeve). Kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit është 2 vite akademike. Numri total i krediteve që duhet të grumbullojë një student për finalizimin e këtij cikli studimi është 120 ECTS. Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të njësisë bazë të institucionit që pranon studentin, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e saj. Studentët e këtij programi studimi diplomohen me punim diplome. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diploma përkatëse.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Rregullorja e DDA përmban në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nga momenti i regjistrimit dhe deri në përfundim të studimeve, apo transferimit të tyre gjë që garanton qartësisht politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë

	kandidatët dhe studentët e programit. Këto politika sigurojnë informim për kriteret, procedurat dhe afatet e aplikimit (duke përfshirë këtu edhe tarifatat përkatëse të programit), transferimit dhe përfundimit të studimeve.								
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret e pranimit dhe vazhdimësisë të studimeve, transferimit nga një program studimi në një tjetër, njohjes së studimeve të kryera në një program tjetër (i plotë ose i pjesëshëm apo edhe i realizuar në kuadër të projekteve të shkëmbimit Erasmus, por jo vetëm) përcaktohen qartë në rregulloren e departamentit dhe atë të programit të studimit (Rregullore e DDA; Rregullore e Programit të Studimit). Ky informacion bëhet publik nëpërmjet faqes zyrtare të Universitetit në seksionin përkatës të departamentit të Drejtimit të Agrobiznesit.								
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Kriteret e pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë të studimeve në DDA-së përcaktohen nga MASR (udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Ministrave apo MASR për vitin akademik përkatës), statuti dhe rregullorja e studimeve të DDA, FEA-s dhe UBT-së (Rregullore e Brendshme e DDA / Rregullore e programit të studimeve).								
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Departamenti që mbulon programin përkatës të studimit komunikon me publikun në këtë drejtim nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, njoftimeve në stendat e fakultetit, takimeve me studentë të nivelit Bachelor të sapodiplomuar etj.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Informacioni i hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin paraqitet qartë në Rregulloren e DDA si dhe atë të programit të studimeve.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

54

<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Informacioni në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme paraqitet qartë në Rregulloren e DDA dhe në atë të programit të studimit si më poshtë: Për të gjithë studentët që kërkojnë të transferojnë studimet, DDA bën të mundur ekuivalentimin e një pjese të programeve sipas përcaktimeve në Statutin e UBT; Periudha dhe procedurat për transferimin e studimeve realizohen në fillimi të vitit akademikë në përputhje me aktet nënligjore të MASR); Studenti që është i interesuar të transferojë studimet në DDA paraqet një kërkesë pranë ZSS të UBT-së dhe dokumentacionin përkatës të nevojshëm. ZSS kryen verifikimet mbi legjitimitetin e institucionit të arsimit të lartë nga vjen studenti, nivelin e programit të studimit që ka ndjekur student si dhe origjinalitetin e dokumentave të paraqitur. Më pas, zyra përcjell në fakultetet përkatëse kërkesat e grumbulluara dhe dokumentacionin e verifikuar; Pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, me urdhër të Dekanit të Fakultetit, ngrihen dhe funksionojnë komisione <i>ad hoc</i> të Njohjes dhe Ekuivalentimit të Studimeve. Komisionet përbëhen nga tre antarë: Zv. Dekani për mësimin dhe kurikulat, përgjegjësi i departamentit dhe përgjegjësi i grupit mësimor, në varësi të programit të studimit dhe programit të modulit që kërkohet të ekuivalentohet. Zv. Dekani për mësimin dhe kurikulat është kryetar komisioni. Vendimi përfundimtar i ekuivalentimit (njohjes) të programeve të studimit firmoset prej tij dhe Dekanit të Fakultetit.</p> <p>Një modul ekuivalentohet) kur ka emërtim të njëjtë/të ngjashëm, apo që në përmbajtjen e tyre, trajtojnë tema mësimore të njëjta dhe ka një përputhje të përmbajtjes së saj dhe të ngarkesës në auditor, në masën mbi 80 % me modulën që zhvillohet në programin e studimeve të DDA-s.</p> <p>Komisioni bën ekuivalentimin e moduleve që ka dhënë studenti me modulën respektivë të programit të studimit, duke patur parasysh kreditet e modulit, programin e modulit, siç përshkruhet më sipër, si dhe notën e marrë.</p> <p>Në funksion të numrit të krediteve të njohura, dekani i fakultetit përcakton vitin ku do të regjistrohet studenti në përputhje me nenet e kësaj rregulloreje.</p> <p>Më pas ky proces bëhet transparent përmes faqes së internetit duke specifikuar detaje që janë në funksion të transparencës së rankimit të studentëve apo njohjes ose jo të moduleve të caktuara.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin</p>	<p>Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre në programin e studimit në këtë mënyrë: Nëpërmjet Rregullores së DDA dhe</p>

e studimit.	<p>Rregullores së programit të studimit departamenti informon qartësisht studentët mbi procedurat dhe kriteret për vlerësimin e dijeve në lëndë të ndryshme të programit të studimit, duke përfshirë këtu: (1) sistemin e vlerësimit, (2) format e vlerësimit, (3) format e kontrollit të dijeve, (4) kushtet për hyrjen në provim, (5) sezonet e provimeve, (6) organizimin e tyre e (7) komisionet e provimit, (8) zhvillimin e provimit, (9) shpalljen e rezultateve të provimit, (10) ankimimi dhe (11) përmirësimi i notës. Format e kontrollit të dijeve edhe pse gjendet në rregulloret e FEA, DDA dhe në atë të programit të studimit, i bëhet me dije studentit në javën e parë të fillimit të mësimit nga pedagogu/pedagogët përgjegjës i/të lëndës përkatëse.</p> <p>Studenti informohet edhe në distancë përmes websiteve personale të pedagogëve në lidhje me elementët e mësimit dhe vlerësimit të tij, nëpërmjet syllabusit apo planit kalendar që plotësohet në fillim të semestrit.</p>			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Departamenti informon studentët përmes stendave të tij, faqes së internetit, apo edhe takime me studentët për kriteret që kërkohet të plotësohen për procedurat e punimit të diplomës. Kriteret janë publike në çdo kohë por intensifikohet komunikimi në mes të semestrit të parë të vitit të dytë. Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës sipas fushave të kërkimit që mbulon departamenti Drejtim Agrobiznesi. Në përfundim të semestrit të tretë, studenti plotëson një formular tip, ku specifikohet emri i studentit, fusha e studimit të kërkuar, propozimi për profesorin udhëheqës pasi është marrë edhe aprovimi i tij. Ky dokument dorëzohet në departament, ku ky i fundit organizon një mbledhje për miratimin e temave dhe propozimeve të studentëve. Departamenti harton listën e studentëve dhe udhëheqësin shkencor të cilat miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit të DDA-s. Departamenti publikon informacion në lidhje me mënyrën e përpunimit të tezës me të gjithë studentët e vitit të fundit (Rregullore se FEA-s / Rregullore e Brendshme e DDA / Rregullore e Programit të Studimi).</p>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	<p>Informimi në këtë drejtim organizohet online nëpërmjet publikimeve në faqen zyrtare të fakultetit dhe fizikisht në ambjentet e FEA. Organizimi i takimeve mbi programet e studimit përkatëse në UBT/FEA/DDA duke përdorur materiale promovuese të ndryshme.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>DDA informon studentët në mënyrë të hollësishme në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit nëpërmjet neneve përkatëse në Rregulloren e DDA dhe Rregulloren e programit të studimit. Ky informacion vendoset në dispozicion të studentëve në ëbsitin e Fakultetit në seksionin e departamentit. Informacioni në ëeb në lidhje me organizimin dhe programet që ofron departamenti krijon mundësinë për të marrë informacionin e duhur në lidhje me organizimin e plotë të studimeve të këtij programi. Në fillim të çdo viti akademik, bëhet i mundur informimi në lidhje me strukturën e vitit akademik në të cilën detajohet kohëzgjatja e vitit akademik, ndarja e tij në semestra si dhe periudha e provimeve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Informacioni në lidhje me lëndët, modulet, mënyrat e vlerësimit etj., apo edhe rregulloret e programit të studimit, planet mësimore etj., jepet në mënyrë të mjaftueshme tek studentët. Psh: Në hard-copy me anë të guidave, rregulloreve të posaçme, fletëpalosjeve, procedurave, etj., të cilat gjenden në sekretari dhe u vihen në dispozicion studentëve të programeve përkatëse; Në formë elektronike në websit-n e universitetit, në seksionin përkatës të DDA, të i cili është i aksesueshëm nga të gjithë studentët si në mjediset e FEA dhe jashtë saj. Këtu mund të gjenden për programin e studimit, rregullorja e programit, kurrikula e plotë me informacionin e nevojshëm për lëndët, ndarjet e tyre në semestra, kreditet. Nga ana tjetër, personeli akademik i departamentit shfrytëzon hapësirën personale në portalin e UBT-së për të komunikuar në mënyrë sa më efikente me studentët në lidhje në lidhje me informacione për leksionet e moduleve përkatëse, rastet studimore, detyrat e kursit si dhe e materialeve të tjera. Në këtë hapësirë të përbashkët studentët kanë akses në leksionet e modulit, syllabusin e tij, strukturën e modulit si edhe mënyrën e administrimit të tij përgjatë semestrit. Ata gjithashtu marrin në këtë hapësirë edhe informacion në lidhje me vlerësimin gjatë vitit. Informacioni i shpallur në stenda në mjediset e</p>

	<p>përcaktuara të FEA-s dhe DDA-së, ku përfshihet kurrikula e plotë me informacionin e nevojshëm për lendët, ndarjet e tyre në semestra, kreditet, orari i mësimi, njoftime të ndryshme, pjesë të rëndësishme të rregullores, rezultatet e kontroleve, etj. Njëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me studentët, njoftimeve në ambjentet e FEA, publikimeve online në faqen zyrtare etj., studentët informohen mbi vendimet e rëndësishme që lidhen me ta, të marra nga Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektorati, Dekanati etj. Gjithashtu ata informohen mbi rezultatet e pyetësorëve, anketave etj.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Qendra e Karrierës dhe Alumni, përgjatë panairëve të karrierës që ka organizuar në UBT, ka nënshkruar 43 marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës (sipërmarrje, institucione publike, OJF). Qendra e Karrierës dhe Alumni, më datë 15.05.2019 organizoi për të gjashtin vit radhazi Panairin e Karrierës pranë mjediseve të kampusit universitar. Ky panair shërben si urë lidhëse ndërmjet sipërmarrjeve, institucioneve publike, organizatave të ndryshme pjesëmarrëse dhe studentëve për të krijuar mundësi pënesimi, praktikë profesionale apo intership. Këtë vit, morën pjesë 46 sipërmarrje dhe organizata të profileve të ndryshme të cilat me anë të stendave përkatëse, ofruan mundësi punësimi dhe praktika profesionale për rreth 536 studentë.</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët mund të marrin informacion të plotë në lidhje me orarin mësimor, ambjentet ku zhvillohet mësimi, lëndët si dhe informacione të tjera të rëndësishme për procesin mësimor të tyre. Ky informacion merret online dhe në ambjentet e fakultetit. Gjithashtu, zyra e studimeve dhe studentëve ndihmon në drejtimin sa më të saktë të lëvizjes në këto ambjente, duke qenë dhe ajo vetë e pozicionuar në ambjent të dukshëm dhe të aksesueshëm lehtësisht.</p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë</p>	<p>Institucioni disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit në të cilin regjistrohet dhe arkivohet i gjithë informacioni në lidhje me studentët nga momenti i regjistrimit deri në çertifikimin përfundimtar, pajisja me diplomën sipas ciklit përkatës. Ky sistem menaxhimi ka integruar sistemin ESSE3 për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve nga aplikimi në Universitet, jeta universitare deri në mbrojtjen e diplomës. Informacioni në lidhje me procesin mësimor bëhet lehtësisht i aksesueshëm përmes tij. Sistemi ESSE3 i mundëson studentit të marrë informacion të nevojshëm edhe në distancë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Në analizën mësimore që DDA përgatit çdo vit, janë të pasqyruara statistikat vjetore në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar në programet përkatëse, që kanë ndërprerë studimet si dhe të diplomuar. Ky informacion regjistrohet dhe ruhet në departament së bashku me të dhëna të tjera për studentët. Këto të dhëna mund të gjenerohen në çdo kohë për çdo vit akademik nga sistemi ESSE3. Departamenti mund të analizojë të dhëna të ndryshme të marra nga sekretaria mësimore, në funksion të analizës mësimore.</p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nëpërmjet sistemit të brendshëm të informacionit, Institucioni ruan të dhënat personale të studentëve. Informacionet ruhen mbi bazën e konfidencialitetit sipas legjislacionit në fuqi. Ato mund të merren vetëm nga personat e autorizuar ose përmes një kërkesë me shkrim sipas legjislacionit në fuqi. Studentët mund të marrin të dhëna mbi ecurinë e tyre përmes accounteve personale në sistem etj (Rregullore e FEAs, Neni 101).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>DDA harton raportin e veprimtarisë mësimore vjetore. Aty analizohen lëndët dhe problematika të tjera për të gjitha programet e studimit. Më pas, pasi i është bërë i njohur anëtarëve të departamentit ky raport, çështjet diskutohen në mbledhje departamenti duke sugjeruar zgjidhjet dhe përmirësimet e mundshme. Më tej përcillen në Dekanat duke u diskutuar në mbledhje pasi janë njohur me të anëtarët e Dekanatit dhe më pas në Rektorat së bashku me raportet e fakulteteve të tjera të UBT.</p>			
Shkalla e përbushjes së	Plotë	Përbushet	Përbushet	Përbushet

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Institucioni përpiqet të përfshijë studentët në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të institucionit. Studentët kanë përfaqësinë e tyre në Senat akademik, Komisionin e cilësisë dhe kurrikulave si dhe në Komisionin e etikës, me një mandat për një periudhë kohore 2 vjeçare (Statuti UBT, Neni 64). FEA ka përfunduar procesin zgjedhor për përzgjedhjen e studentëve që do të përfshihen në këto komisione për një periudhë 2 vjeçare. Gjatë këtij procesi studentët kanë patur mbështetjen e personelit dhe infrastrukturës së fakultetit për të organizuar mbledhjet e hapura apo shpalosur angazhimin e tyre.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Për një periudhë 2 vjeçare janë organizuar 4 mbledhje (3 mbledhje të komisionit të etikës dhe 1 mbledhje e komisionit të cilësisë dhe kurrikulave). Mbledhjet e komisioneve janë realizuar me një proces transparent duke i njoftuar përfaqësuesit e studentëve përmes kontakteve që kanë depozituar në fakultet (si psh. adresa e emailit apo numri i telefonit). Studentët gjithashtu organizohen në Këshillat studentore, ku shprehin mendimet dhe propozimet e tyre për problematika të ndryshme duke përfshirë këtu edhe çështje të planeve dhe programeve të studimeve apo të procesit mësimor. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve në institucionet e arsimit të lartë. Këto këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë. Këshillat e studentëve zgjidhen çdo dy vjet nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi (Statuti i UBT). Më shumë shfrytëzohet opinioni i studentëve që merret nga anketat e realizuara se nga përfaqësitë e tyre në komisionet përkatëse duke qenë se nuk kanë qenë shumë aktiv.
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të	Për të ndërthurur sa më mirë teorinë me praktikën, programi i studimit ka një ndarje fleksibël në lëndë të ndryshme për sa i përket pikëve që fitohen gjatë vitit dhe atyre që merren vetëm me

<p>studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>anë të provimit përfundimtar. Kjo formë vlerësimi inkurajon angazhimin e plotë të studentëve gjatë gjithë kursit, por gjithashtu i parapërgatit ata për sezonin e provimeve ku mjafton vetëm një përsëritje e asaj çfarë kanë mësuar gjatë semestrit. Gjatë takimit me studentët u konstatua se Departamenti është bashkëpunues dhe i asiston në procesin e njohjes së lëndëve apo krediteve të fituara në studime të mëparshme. Procedura fillon me paraqitjen e kërkesës së studentit pranë ZSS duke paraqitur dokumentacionin përkatës, i cili kalon në procesin e vërtetimit të origjinalitetit dhe më pas kalohet tek instancat përkatëse që kryejnë procedurën e vlerësimit të përputhshmërisë së programeve duke konkluduar me një vendim. Kur kërkesa e studentëve është për lëndë brenda Universitetit, procedura është më e thjeshtë (Rregullore e studimeve universitare).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Strukturat drejtuese të Universitetit gjatë tre viteve të fundit kanë ndërmarrë një iniciativë llogaridhënie para asamblesë akademike të institucionit për çështje që kanë të bëjnë më të gjithë veprimtarinë e UBT ku një vend të rëndësishëm zë edhe llogaridhënia dhe diskutimi për cilësinë e programeve të studimit. Gjatë këtij procesi përfshihen edhe studentët sepse ftohen të marrin pjesë në këtë diskutim. Proçesi përfshin vijimësinë e proçesit mësimor si edhe problematikat e vërejtura gjatë viteve paraardhëse akademike, masat e marra gjatë viti të fundit akademik dhe impakti i tyre. Më tej vazhdohet me planin e ndërhyrjeve për vitin e ardhshëm akademik. Një kontribut tjetër në këtë kontekst janë rezultatet e marra nga anketimi i realizuar me studentët. Anketat e realizuara në hard-copy ku merret një opinion më specifik në lidhje me modulën dhe pedagogun përkatës dhe online, ku studentëve i kërkohet informacion më i përgjithshëm mbi procesin mësimor dhe çështje të tjera. Ky proces ndodh 2 herë në vit, përpara sezonit të provimeve, për të evituar ndikimin apo deformimin e vlerësimit. Pasi përpunohen të dhënat dhe nxirret rezultati, grupi i posaçëm i punës përgatit një raport, të cilin e vendos në dispozicion të departamenteve përkatëse. Rezultatet e këtij pyetësori janë pjesë e analizën vjetore të njësisë kryesore dhe asaj bazë.</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Departamenti informon qartësisht studentët mbi procedurat dhe kriteret për vlerësimin e dijeve në lëndë të ndryshme të programit të studimit, duke përfshirë këtu: sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit, format e kontrollit të dijeve, kushtet për hyrjen në provim, sezonet e provimeve, organizimin e tyre e komisionet e provimit, zhvillimin e provimit, shpalljen e rezultateve të</p>

	<p>provimit, ankimimi dhe përmirësimi i notës.</p> <p>Studentët, në seksionet përkatëse të anketave (në hard-copy dhe online) që realizohen nga Institucioni mund të japin mendimin e tyre në lidhje me kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, duke përfshirë mundësinë e ankimimit të rezulttit, rishikimit dhe reflektimit në të. Pedagogët janë të hapur dhe bashkëpunues për të diskutuar me studentin në rast se do të ngriheshin pretendime për rishikimin e vlerësimit. Studentët rezultojnë të kënaqur në lidhje me këtë aspekt dhe nuk kishin hasur situatë të pakëndshme.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Disa nga format e informimit për shërbimet ndaj studentëve janë: Sekretaria e Departamenti, ku studenti merr informacione mbi organizimin e mësimit, aktivitete të ndryshme, diplomimi, procesin mësimor, etj; Sekretaria mësimore, ku studenti merr shërbime, informohet mbi ecurinë dhe progresin e tij në këtë program studimi; Zyra e këshillimit të karrierës, ku studentët marrin informacion mbi trajnimet, praktikat dhe ofertat e punësimit. Këto procedura janë të përcaktuara në rregulloren e departamentit (Rregullore e DDA, Kreu XIV)
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Përveç strukturave ndihmëse në IAL, i rëndësishëm është edhe informimi online. Përmes portaleve të pedagogëve studentët krijojnë një komunikim të vazhdueshëm për procesin mësimor, pasi në të mund të gjejnë informacione për leksionet e moduleve përkatëse, rastet studimore, detyrat e kursit si dhe e materialeve të tjera. Në këtë hapësirë të përbashkët studentët kanë akses në leksionet e modulit, syllabusin e tij, strukturën e modulit si edhe mënyrën e administrimit të tij përgjatë semestrit. Ata gjithashtu marrin në këtë hapësirë edhe informacion në lidhje me vlerësimin gjatë vitit.
Kriteri 3. Institucioni u ofron	Institucioni ka një zyrë qendrore karriere dhe alumni e cila

<p>studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>koordinon punën për 5 fakultete. FEA në veçanti ka zyrën e tij të këshillimit të karrierës e cila luan rol të rëndësishëm në këshillimin dhe orientimin e studentëve në këtë drejtim. Për t'i dhënë mundësi studentëve për të kryer praktika profesionale, intership apo dhe mundësi punësimi, Qendra e Karrierës, përgjatë panairëve të karrierës që ka organizuar në UBT, ka nënshkruar 43 marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës (sipërmarrje, institucione publike, OJF). Aktivitet shumë i rëndësishëm në këtë drejtim është Panairi i Karrierës i organizuar në 15 Maj nga zyra e karrierës dhe alumni, për nga numri i kompanive pjesëmarrëse, studentëve të interesuar etj. Një tjetër funksion që realizon zyra qëndrore në bashkëpunim me zyrat e këshillimit të karrierës për fakultet përkatëse është gjurmimi i studentëve të diplomuar ndër vite. Studentët e diplomuar shprehen se profilet e punës që ofron tregu përputhen me njohuritë dhe aftësitë që ofrojnë programet e studimeve në UBT, duke konfirmuar që diploma e UBT është e vlefshme për tregun e punës. Nga Raporti i performances së QKA rezulton se Bordi i Alumnit si strukture formale është ngritur, por ende nuk ka realizuar asnjë aktivitet sipas parashikimeve të planit të punës apo edhe përshkrimeve në rregulloren e QKA (fq. 19). Një kontribut i rëndësishëm për programin e studimit do të ishte mendimi i këtij bordi duke qënë se ata tashmë janë pjesë e tregut të punës dhe njohin më nga afër problematikat dhe kërkesat e tregut në lidhje me aftësitë dhe kompetencat e nevojshme të studentëve potencial i ardhshëm për punësim. Megjithatë duke parë rezultatet e mësipërme dhe nga bisedimi i realizuar me përfaqësuesit e kësaj zyre kërkohet një koordinim dhe bashkëpunim më i mirë me departamentin, personelin akademik dhe këto zyra në ndërgjegjësimin e studentëve për rëndësinë që mbart kjo zyrë në ndërtimin e karrierës së studentit. Një mundësi e mirë për të patur një impakt të konsiderueshëm në gjurmimin e studentëve të diplomuar mund të krijohet nëpërmjet Projektit Gradua, i cili do të lejojë mbledhjen e të dhënave lidhur me performancën e tyre; lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) dhe do të krijojë lehtësi në vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet Universitetit dhe bizneseve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Sipas Manualit të Cilësisë, UBT mbështet punën tek ndershmëria, kreativiteti, liria akademike, bashkëpunimi dhe shkëmbimi për kërkimet shkencore dhe edukimin (Manuali i Cilësisë, fq.4). Ai ka përgjegjësinë që ti ofrojë shoqërisë shqiptare një cilësi të lartë të programeve akademike, hulumtuese dhe shërbimesh duke treguar se janë plotësuar standardet e cilësisë (Manuali i Cilësisë, fq.5). Për të arritur sigurimin e cilësisë, UBT ka zhvilluar politikën e sigurimit të cilësisë duke ngritur një sistemin të menaxhimit të cilësisë në Universitet. Ai përfshin (Manuali i Cilësisë, fq.5): angazhimin e strukturave drejtuese për të garantuar cilësinë; sigurimin e burimeve që garantojnë dhe përmirësojnë e cilësisë; zhvillimi i programeve të studimit cilësore që plotësojnë nevojat e shoqërisë; përcaktimin e procedurave, standardeve dhe metodave që ndihmojnë në monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë. Gjithashtu nga dokumentacioni dhe takimet e realizuara mund të thuhet se njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë akademike monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore. Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë harton pyetësin me studentët në lidhje me procesin mësimor dhe çdo element që lidhet me të. Për të mos patur ndikime apo deformime anketimi kryhet në fund të çdo semestri por përpara sezonit të provimeve. Studentëve iu vihet në dispozicion edhe një pyetësor online ku ata mund të japin opinionin e tyre në lidhje me procesin mësimor në përgjithësi. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të	

institucionit.	akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. Universiteti në fund të çdo viti akademik kryen rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij. Dekani i Fakultetit, aktivizon komisionin ad-hoc për rishikimin e programeve të studimit dhe rregullores së tyre. Realizimi me sukses i procesit të rishikimit kërkon grumbullimin e të dhënave të nevojshme përgjatë vitit akademik. Departamenti merr opinione nga studentët në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor në të gjitha modulet (Manuali i Cilësisë/ Rregullore e Programit të Studimit / Rregullore e Brendshme e DDA / Rregullore se FEA).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	Spektori i Mësimin, Kurrikulave dhe Vlerësimin Institucional është përgjegjës për ndjekjen e problemeve që lidhen me mësimin dhe vlerësimin institucional (Rregullore e DZHKKVI & DITNJ / Statuti i UBT) Zyra e Mësimin dhe Kurrikulave kujdeset për menaxhimin e procesit të rishikimit të kurrikulave të programeve të ndryshme dhe reflektimin e saj në sistemin ESSE3, analizës mësimore, procesin e anketimit nga ana e studentëve, si dhe procesin e kontrollit në auditor për të siguruar mbarëvajtjen e programeve të studimit. Ajo çdo vit menaxhon procesin e rishikimit të kurrikulave të programeve të ofruara nga të gjitha fakultetet e UBT. Është një procedure normale dhe e njëjtë për çdo cikël studimi, e cila fillon me mbledhjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm të programeve të studimit në lidhje me kurrikulën përkatëse për çdo program. Një tjetër instrument matës për mbarëvajtjen e programit të studimit është menaxhimi i rezultatit të analizës mësimore, process i përvitshëm, nën drejtimin e Zv Rektorit përgjegjës për mësimin. Kjo zyrë pasi merr informacionin, raportet nga fakultetet përkatës, e përpunon atë dhe prodhon produktin që është raporti
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	

Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë

përfundimtar përmbledhës i analizës mësimore të insitucionit, Procedurë tjetër është edhe përpunimi i anketave të realizuara në hard-copy, ku merret një opinion më specifik në lidhje me modulën dhe pedagogun përkatës dhe online, ku studentëve i kërkohet informacion më i përgjithshëm mbi procesin mësimor dhe çështje të tjera. Kjo zyrë kujdeset gjithashtu edhe për procedurën që lidh kurrikulën me sistemin ESSE3. Nëse ka ndryshime të kurrikulës (spostime të moduleve në vite apo semestra), ato duhet të verifikohen dhe më pas të reflektohen me anë të azhormimit të systemit duke lejuar që studenti të ketë të pasqyruar informacionin e saktë në lidhje me modulet dhe provimet përkatëse.

Në këto procese rol të rëndësishëm luan edhe Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit institucional. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore. Metodologjia e punës konsiston në identifikimin e detyrave që do të kryhen gjatë vitit akademik dhe përcaktimin e istancave përkatëse përgjegjëse për realizimin e tyre dhe afatet të përmbushjes së tyre. Kjo zyrë kujdeset për hartimin e pyetësorit dhe kalimin e formës së tij në instancat përkatëse (Rektorati dhe Senati) për të marrë miratimin. Anketa është e thjeshtë, disponohet në hard-copy dhe synon tërheqjen e opinionëve të studentëve në lidhje me modulën dhe pedagogun përkatës. Ky proces ndodh 2 herë në vit, përpara sezonit të provimeve, për të evituar ndikimin apo deformimin e vlerësimit. Pasi përpunohen të dhënat dhe nxirret rezultati, grupi i posaçëm i punës përgatit një raport, të cilin e vendos në dispozicion të departamenteve përkatëse. Rezultatet e këtyre pyetësorëve janë pjesë e analizës vjetore të njësisë kryesore dhe asaj bazë. Analiza mësimore është një proces i përvitshëm nën drejtimin e Zv Rektorit përgjegjës për mësimin. Kjo zyrë, pasi merr raportet nga fakultetet përkatës, ku pasqyrohen masat që duhet të ndërmerren për vitin ardhshëm akademik në përputhje me problematikën e evidentuara, përpunon këtë informacionin dhe prodhon produktin që është raporti përfundimtar përmbledhës i analizës mësimore të insitucionit. Në fund të raportit, nxirren detyrat dhe afatet kohore të përmbushjes së tyre në lidhje me pika të dobëta që mund të evidentohen, të cilat kërkojnë përmirësim për vitin pasardhës. Gjithashtu kjo zyrë kujdeset edhe për mbarëvajtjen e procesit të sezonit të provimeve, respektimin e orarit nga pedagogët. Një moment tjetër i rëndësishëm është edhe matja e performances së pedagogëve

	<p>çdo vit e cila realizohet në 3 drejtime: procesit të edukimit; procesit të kërkimit; procesit të divulgimit, përcjellja publike e dijeve dhe aftësive në shërbim të shoqërisë.</p> <p>Dokumentacioni i cili përfshin procesin e rishikimit të kurrikulave dhe analizat mësimore, një proces që zhvillohet gradualisht duke filluar nga departamentet deri tek kontrolli nga strukturat përkatëse, kalon nga poshtë-lart drejt instancave më të larta (Senat dhe Rektorat) të clat marrin vendime mbi bazën e këtij informacioni të paraqitur. Këto vendime kalohen nga lart-poshtë dhe i bëhen të ditur strukturave, departamenteve apo personave përkatës. Ky proces finalizohet me një plan masash i cili është në funksion të përmirësimit të ecures së programeve të studimit dhe cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Procesi i vlerësimit të brendshëm zhvillohet gradualisht duke filluar nga departamentet dhe më pas kontrolli nga strukturat përkatëse drejt instancave më të larta (Senat dhe Rektorat) të clat marrin vendime mbi bazën e këtij informacioni të paraqitur. Sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet në tre mënyra nëpërmjet: (1) kontrollit të pedagogëve të rinj nga pedagogë me përvojë dhe pjesëmarrja e pedagogëve të rinj në leksionet e realizuara nga lektorët me përvojë, për të fituar eksperiencë; (2) vlerësimit të performacës së çdo pedagogu mbi bazë vjetore; dhe (3) anketave drejtuar studentëve. Analiza e këtyre elementeve bëhet në rang departamenti dhe më pas përfshihet në analizën e punës mësimore dhe asaj shkencore. Nga ana e tij institucioni në mënyrë të përvitshme harton raportet e veprimtarisë institucionale të cilat përmbledhin pikërisht raportet e analizës së procesit mësimor dhe analizës së kërkimit për secilin fakultet.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së</p>	

<p>programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Vlerësimi me notë/pikë (materializuar në procesverbal); Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë (materializuar në procesverbal përfundimtar); Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet (materializuar në procesverbal përfundimtar); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Këto elemente të metodave të drejtpërdrejta të vlerësimit faktohen në një seri dokumentash duke filluar me regjistrin e pedagogut (hard copy dhe elektronik) i cili pasqyron vlerësimet e studentëve deri para hyrjes në provimin final. Procesverbali final pasqyron sërish këto vlerësime dhe shton edhe vlerësimin e provimit final duke konkluduar me vlerësimin përfundimtar të studentit në modulën në fjalë. Me qëllim përmirësimit e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit që ofrohen, UBT në bashkëpunim me Qendrën e Karrierës dhe Alumni, ka organizuar pyetësorë të vazhdueshëm që kanë si qëllim gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet. Një aspekt i rendësishme i këtij sondazhi lidhet me përmirësimin e vazhdueshëm dhe përputhjen e kurrikulave të studimeve me vendet e punës që mbajnë aktualisht të diplomuarit. Studentët e diplomuar shprehen se profilet e punës që ofron tregu përputhen me njohuritë dhe aftësitë që ofrojnë programet e studimeve në UBT, duke konfirmuar që diploma e UBT është e vlefshme për tregun e punës.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi VL.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni nëpërmjet kuadrit rregullator, përcakton dhe harton politika dhe procedura që garantojnë vlerësimin e cilësisë (Rregullore e Programit të Studimit / Rregullore e Brendshme e DDA / Rregullore e FEA). Në procesin e sigurimit të cilësisë për programet e studimit në UBT janë përfshirë studentët, personeli akademik dhe strukturat e sigurimit të cilësisë në UBT.</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Programet e studimit kanë pësuar ndryshime të vazhdueshme në aspektin kurrikular (Manuali i Cilësisë). Në statutin e UBT parashikohen politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, ku pranë Degës së Mësimit, Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional është organizuar dhe funksionon Njësia e Sigurimit Brendshëm të Cilësisë, e cila fokusohet në këto veprimtari: Evidentimi i problematikave të lidhura me mësimin; Evidentimi dhe ndjekja e problematikave të lidhura me cilësinë e mësimdhënies; Sigurimin i bazës së të dhënave për cilësinë e mësimdhënies; Vlerësimi periodik i rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore; Realizimi i studimeve për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Universiteti; Organizimi dhe ndjekja e zhvillimit të pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për çdo programi studimi; Orientimi dhe udhëheqja metodike të procedurave të veprimit për vlerësimin e brendshëm në departamente dhe fakultete; Vlerësimi i performancës së stafit akademik. Raportet e vlerësimit, të kryera nga njësitë për sigurimin e brendshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Në planin e masave të publikuar nga rektorati i UBT, janë përcaktuar qartë detyrat, dhe përshkallëzimi i tyre nga njësia kryesore, tek njësia bazë e deri në nivel GMK ku disa prej tyre brenda këtij plani masash lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, si kontrolli i vazhdueshëm i kurrikulave, syllabuseve, organizimi i pjesëmarjeve në orë leksionesh të hapura apo ftesa ndaj lektorëve të jashtëm me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë etj. Personeli akademik dhe administrativ ka një rol kyç në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor të Institucionit dhe me Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimin Institucional që ka përgjegjësinë institucionale. (Manuali i Cilësisë).</p> <p>Aktorët e brendshëm janë përmendur gjerësisht më lart por institucioni konsultohet edhe me aktorë të jashtëm dhe palë të treta, për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. Nga takimi i realizuar me përfaqësueset e Sektorit të Mësimit, Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional mësuam se zhvillohen pyetësorë, ku seksione të veçanta të tij i drejtohen bizneseve që sot operojnë në treg për të tërhequr opinionin e tyre</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	

	në lidhje me ndryshimet që mendohen të bëhen në kurrikulat e programit në përmirësimin e tyre, nëse janë të nevojshme këto ndryshime në përputhje me kërkesat e tregut, apo nëse ka çështje të tjera, drejtime specifike që kërkojnë vëmendje të veçantë për ndërhyrje.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Institucioni përcakton në dokumente përkatëse politika dhe strategji për organizimin dhe veprimtarinë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, transparente, të cilat bëhen publike. Siç u diskutua edhe në takimin e realizuar Sektorit të Mësimin, Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional, informacioni në lidhje me instrumentet matëse që përdoren për vlerësimin dhe ecurinë e programeve të studimit përfshihet në dokumentacionin vlerësues të këtij sektori. Rezultatet e anketimit komunikohen publikisht për të gjithë anëtarët e stafit të UBT. Rezultatet finale të përfituara prej pyetësorëve bëhen publike, duke ja komunikuar stafit. Rezultatet e anketimeve si dhe analizat në nivel departamentesh bëhen pjesë e raporteve të pjesshme dhe vjetore që përgatitet në fund të çdo viti akademik nga ky sektor përkatës. Publikimi i çfarëdo rezultati privat që lidhet direkt me individë të caktuar bëhet brënda respektimit të lirisë akademike dhe ruajtjes së privatësisë. Raportet individuale i bëhen të njohura çdo stafi akademik dhe ndihmës në adresën e tyre elektronike. UBT harton një plan masash i cili adreson në mënyrë të detajuar masat/ ndërhyrjet që duhet të ndërmerren për të përmirësuar ecurinë e programeve të studimit për vitin e ri akademik. (Analiza mësimore UBT 2018 / Plan i masave FEA)
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	
	Vlerësimi i brendshëm i strukturave dhe programeve të studimit kryhet periodikisht sipas dispozitave të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë. Ndërmjetësuesit, përmes Koordinatorit të Sigurimit të Cilësisë hartojnë dhe japin raporte për aktivitetet

dhe iniciativat e reja që lidhen me sigurimin e cilësisë për të gjitha njësitë e UBT. Funkcionimi i Komisioneve është i rregulluar nga Statuti, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Komisionet koordinojnë, përpilojnë dhe raportojnë aktivitete dhe iniciativa të reja lidhur me sigurimin e cilësisë në të gjitha njësitë e UBT nëpërmjet Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Koordinatorit Institucional. Komisioni i Sigurimit të Cilësisë së Institucionit është përgjegjës para Senatit për punën e tij. Ai diskuton dhe vendos për çështje të fushës së menaxhimit të cilësisë dhe promovon, kooperon dhe monitoron aktivitetet e sigurimit të cilësisë në universitet dhe anëtarët e tij. Për më tepër ai monitoron vetëvlerësimin impaktin dhe procedurat e vlerësimit të universitetit. Komisioni përgatit propozime për aktivitete për cilësinë, duke përfshirë prioritetet që duhet të kryhen në universitet në vitin pasardhës që vijnë si rezultat i impaktit që kanë dhënë masat e marra gjatë vitit paraardhës akademik. Propozimet e tij ja prezanton Senatit akademik. (Manuali i Cilësisë, fq.18) Strukturat drejtuese të Universitetit gjatë tre viteve të fundit kanë ndërmarrë një iniciativë llogaridhënie para asamblesë akademike të institucionit për çështje që kanë të bëjnë më të gjithë veprimtarinë e UBT ku një vend të rëndësishëm zë edhe llogaridhënia dhe diskutimi për cilësinë e programeve të studimit. Gjatë këtij procesi përfshihen edhe studentët sepse ftohen të marrin pjesë në këtë diskutim. Proçesi përfshin vijimësinë e proçesit mësimor si edhe problematikat e vërejtura gjatë viteve paraardhëse akademike, masat e marra gjatë viti të fundit akademik dhe impakti i tyre. Më tej vazhdohet me planin e ndërhyrjeve për vitin e ardhshëm akademik (Njoftim i takimit me asamblenë).

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Menaxhim i Ndërmarrjeve”, me profil: “Menaxhim i Ndërmarrjeve të Agrobiznesit”, të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit mbulohet nga staf me eksperiencë të mjaftueshme akademike, pjesëmarrje në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, etj.
2. Fushat kërkimore-shkencore të anëtarëve të stafit akademik që mbulon programin e studimit përgjithësisht përputhen me natyrën e programit dhe të lëndëve apo moduleve specifike që ata zhvillojnë.
3. Infrastruktura ku zhvillohet procesi mësimor si psh. salla mësimi, laboratorë etj. dhe ofrohen shërbime të tjera për studentët është e mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e të gjitha palëve.
4. Studentët informohen dhe marrin pjesë në konferencat studentore të organizuara në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit.

Pika të dobëta:

1. Lidhur me praktikën profesionale, konstatuar edhe gjatë vizitës në Institucion, u gjykua se shpeshherë studentëve nuk u jepet asistencë e duhur profesionale dhe angazhimi i duhur nga ana e stafit të insitucioneve ku ata zhvillojnë praktikën.
2. Bordi i Alumni, megjithëse ka përpjekje mjaft të mira në këtë drejtim nga qendra e karrierës, ende nuk është funksional në masën e duhur.

Rekomandime:

1. Institucioni, të rrisë angazhimin e tij për lidhjen e marrëveshjeve të reja në kuadër të realizimit të praktikës profesionale si dhe të shtojë mbikëqyrjen në vendin e praktikës.
2. Të fillojë funksionimi i vazhdueshëm i Bordit të Alumnit si mundësi ndërlidhje me tregun e punës, shkëmbimit të eksperiencave dhe mbështetjes së vazhdueshme për programin e studimit.
3. Literatura bazë dhe ajo plotësuese të zgjerohet dhe përditësohet më tej për të kryer sa më mirë funksionin e një programi studimi Master.

Conclusions of the evaluation of the study program of the second cycle Professional Master in “Enterprise Management”, with profile: “Agrobusiness Management Enterprise”, of the Higher Education Institution “Tirana Agricultural University”

Strengths and affirmations:

1. The study program is covered by staff with sufficient academic experience, participation in national and international research projects, national and international scientific conferences, etc.
2. The research fields of the academic staff members of the study program are generally consistent with the nature of the program and the specific courses or modules they develop.
3. Infrastructure where teaching process takes place such as classrooms, laboratories etc. and where other services to students are offered, is sufficient to meet the requirements of all parties.
4. Students are informed and participate in student conferences organized at the Faculty of Economics and Agribusiness

Weaknesses:

1. Regarding the professional practice, also found during the visit to the Institution, it was judged that students are often not provided with the appropriate professional assistance and engagement by the staff of the institutions where they develop the practice.
2. The Alumni Board is still not working properly despite the good efforts of the career centers

Recommendations:

1. Institution has to increase its commitment to sign new agreements in the framework of professional practice and to increase supervision at the place of practice.
2. To start the continued functioning of the Alumni Board, as an opportunity to fit with the labor market, exchange experiences and provide ongoing support for the study program.
3. The basic and supplementary literature should be further expanded and updated to better perform the function of a Master's degree program.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X